



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.90

2004

9 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9299 datë 28.10.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimin III/1, Amendament i Konventës së Bazelit “Për lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre.....	6387
Ligj nr.9300 datë 28.10.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në shtojcën “A” të Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF) “Për rregullat uniforme për kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve (CIV)”.....	6388
Ligj nr.9304 datë 28.10.2004	Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale.....	6409
Ligj nr.9306 datë 4.11.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për ripranimin e personave”.....	6414
Ligj nr.9307 datë 4.11.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme”.....	6418

Dekret nr.4409 datë 26.11.2004	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare.....	6422
Urdhër i MF nr.2, datë 3.12.2004	Për sekuestrimin e aseteve të shtetasit arab Yasin Al- Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c)Yassin Kadi, ç) Kadi Jassin, d)Yassin Abdullah Kadi.....	6423

LIGJ
Nr.9299, datë 28.10.2004

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË VENDIMIN III/1, AMENDAMENT
I KONVENTËS SË BAZELIT “PËR LËVIZJEN NDËRKUFITARE TË MBETJEVE TË
RREZIKSHME DHE ASGJËSIMIN E TYRE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Vendimin III/1, amendament i Konventës së Bazelit “Për lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4398, datë 17.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIMI III/1
AMENDAMENT I KONVENTËS SË BAZELIT

Konferenca,

duke rikujtuar se në takimin e parë të Konferencës së Palëve të Konventës së Baselit u shtrua një kërkesë për ndalimin e transportimit të mbetjeve të rrezikshme prej vendeve të idustrializuara për vendet në zhvillim;

duke rikujtuar vendimin II/12 të Konferencës,

duke vënë në dukje se:

- Grupi teknik i punës është instruktuar prej kësaj Konference për të vazhduar punën e saj mbi karakterizimin e rrezikshmërisë së mbetjeve që janë subjekt i Konventës së Baselit (vendimi III/12);

- Grupi teknik i punës ka filluar tashmë punën e tij për përmirësimin e listave të mbetjeve që janë të rrezikshme dhe mbetjeve që nuk janë subjekt i kësaj Konvente;

- Ato lista (dokumenti UNEP/CHW.3/Inf.4) japin udhëzime të rëndësishme, por nuk janë të kompletuara apo të pranuar plotësisht;

- Grupi teknik i punës do të përgatisë udhëzime teknike për të asistuar çdo palë ose shtet që ka të drejtën të përfundojë marrëveshje ose rregullore, përfshirë ato sipas nenit 11 në lidhje me lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme.

1. Instrukton grupin teknik të punës që t’i jepet prioritet të plotë kompletimit të punës për karakterizimin e rrezikshmërisë së mbetjeve dhe përmirësimit të listave dhe udhëzuesve teknikë në mënyrë që t’i paraqesë ato për miratim në takimin e katërt të Konferencës së Palëve;

2. Vendosi që Konferenca e Palëve do të marrë në takimin e katërt të saj një vendim mbi një/disa lista;

3. Vendos të adaptojë amendamentet e mëposhtme të Konventës:

“Futja e paragrafit të ri hyrës, 7 bis:

Duke pasur parasysh se lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme, sidomos për vendet në zhvillim, rrezikojnë të mos marrin parasysh administrimin e drejtë mjedisor të mbetjeve të rrezikshme, ashtu sikundër është kërkuar nga kjo Konventë”

Futja e nenit të ri 4A:

1. Çdo Palë e listuar në aneksin VII duhet të ndalojë të gjitha lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme që janë të destinuara për veprime sipas aneksit IV/A për në shtetet që nuk janë të listuara në aneksin VII.

2. Çdo Palë e listuar në aneksin VII duhet të heqë nga përdorimi prej datës 31 dhjetor 1997 dhe ndalohet që nga kjo datë të gjitha lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme sipas nenit 1 paragrafi 1(a) të Konventës, të cilat janë të destinuara për operacione në përputhje me aneksin IV B në shtetet që nuk janë të listuara në aneksin VII. Lëvizje të tilla ndërkufitare nuk do të ndalohen derisa mbetjet të jenë të karakterizuara si të rrezikshme sipas Konventës.

ANEKS VII

Palët dhe shtetet e tjera të cilat janë OECD, EC, “Litenshtein”.

LIGJ

Nr.9300, datë 28.10.2004

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTOJCËN “A” TË KONVENTËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR HEKURUDHOR (COTIF) “PËR RREGULLAT UNIFORME PËR KONTRATËN E TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE DHE TË BAGAZHEVE (CIV)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Shtojcën “A” të Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF) “Për rregullat uniforme për kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve (CIV)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4399, datë 17.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

SHTOJCA A
E KONVENTËS MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR HEKURUDHOR (COTIF),
9 MAJ 1980

RREGULLAT UNIFORME MBI KONTRATËN E TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR
HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE DHE TË BAGAZHEVE (CIV)

me
Dispozitat plotësuese të shteteve (DCE),
Dispozitat plotësuese uniforme (DCU).
(të zbatueshme duke filluar nga 1 maji 1985)

Vërejtje paraprake
Ky botim përmban:

- Rregullat uniforme lidhur me kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve (CIV) të 9 majit 1980;
 - Dispozitat plotësuese të shteteve (DCE) të rregullave uniforme CIV (pas tabelës së lëndës);
 - Dispozitat plotësuese uniforme (DCU);
- CIV-i hyn në fuqi më 1 janar 1985.

Konform nenit 9, 2 e) të Konventës lidhur me transportet ndërkombëtare hekurudhore (COTIF), Zyra Qendrore e Transporteve Ndërkombëtare Hekurudhore (OCTI) publikon listën e linjave CIV.

Në vijim të neneve të ndryshme të CIV-it janë hartuar dispozita plotësuese uniforme (DCU) që ndjekin nenet. Numrat e këtyre DCU janë treguar nëpërmjet simbolit }, në anë të dispozitës së CIV-it, së cilës i referohet DCU-ja.

Ndërmarrjet e transportit, në trafikun e të cilëve zbatohet CIV-i dhe dispozitat plotësuese uniforme duke filluar nga 1 maji 1985, figurojnë në listën e botuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Transporteve Hekurudhore (CIT).

Dispozitat plotësuese të Shteteve (DCE) që interpretojnë rregullat uniforme lidhur me kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve (CIV), shtojca A e COTIF-it, në rastin e ndarjes së administrimit të infrastrukturës hekurudhore dhe të shfrytëzimit të shërbimeve të transportit në ndërmarrjeve hekurudhore.

1. Gjatë regjistrimit të linjave hekurudhore në kuptimin e nenit 2, pika 1 të COTIF-it, mjafton që organizmi që administron infrastrukturën të regjistrohet në listën e linjave CIV.

2. Nuk ka “shfrytëzim” në kuptimin e nenit 2 pikave 1 dhe 2 të CIV-it kur “hekurudha” në fjalë është njëkohësisht administruese e infrastrukturës dhe që kryen shërbime të transportit hekurudhor.

3. Me përjashtim të nenit 2 të CIV-it, me termin “hekurudhë” ose me termin “atë që sipas listës së linjave të parashikuara në nenet 3 dhe 10 të Konventës, shfrytëzon linjën” (neni 26, pika 4 i CIV-it), kuptojmë atë që kryen shërbime të transportit hekurudhor në linjat CIV.

4. Për aq sa në një transport ndërkombëtar hekurudhor operon vetëm një shfrytëzues i shërbimeve të transportit hekurudhor, atëherë autorizimet e dhëna nga CIV-i për të miratuar dispozitat kundërshtuese, qoftë në tarifat, qoftë konvencionalisht duhet të kuptohen në senset që ky shfrytëzues i shërbimeve të transportit hekurudhor mund të realizojë transportin nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale korresponduese, sidomos në kuadrin e neneve 5 pika 3, 17 pika 4, dhe 25 pika 2 të CIV-it.

5. Këto dispozita plotësuese hyjnë në fuqi dhe publikohen sipas formës së parashikuar nga ligjet dhe dispozitat e çdo shteti anëtar. Dispozitat plotësuese dhe hyrja e tyre në fuqi i komunikohen Zyrës Qendrore dhe kjo menjëherë jua bën të njohur ato të gjitha shteteve të tjera anëtare.

KREU I PARË TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Fusha e zbatimit

1. Nën rezervën e përjashtimeve të parashikuara në nenet 2, 3 dhe 33, rregullat uniforme zbatohen për çdo transport të udhëtarëve dhe të bagazheve, duke përfshirë aty automjetet, të kryera me bileta të transportit ndërkombëtar të vendosura për një udhëtim, që përshkon territoret e të paktën dy shteteve dhe që përmbajnë ekskluzivisht linja të regjistruara në listën e parashikuar në nenet 3 dhe 10 të Konventës, si dhe në rast nevojë, ndaj transporteve të ngjashme konform nenit 2 pika 2, kryeradha 2 e Konventës.

Rregullat uniforme, përsa i përket përgjegjësisë së hekurudhës në rast vdekjeje ose plagosjeje të udhëtarëve, zbatohen gjithashtu ndaj personave që shoqërojnë një dërgesë, transporti i së cilës kryhet konform rregullave uniforme në lidhje me kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të mallrave (CIM).

2. Tarifat ndërkombëtare fiksojnë marrëdhëniet për të cilat jepen biletat e transportit ndërkombëtar.

3. Në rregullat uniforme termi “stacion” mbulon: stacionet hekurudhore, portet e shërbimeve të lundrimit dhe çdo ndërtim të ndërmarrjeve të transportit, që është i hapur për publikun për zbatimin e kontratës së transportit.

DCU

1. Në rastin e ndarjes së administrimit të infrastrukturës hekurudhore dhe të shfrytëzimit të shërbimeve të transportit hekurudhor, me hekurudhë ose rrjet, në dispozitat plotësuese uniforme (DCU), kuptojmë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit hekurudhor në linjat CIV.

2. Në rastin e ndarjes së administrimit të infrastrukturës hekurudhore dhe të shfrytëzimit të shërbimeve të transportit hekurudhor, termi “stacion” në CIV dhe DCU, kur është fjala për organin veprues, përdoret për shfrytëzuesin e shërbimeve të transportit hekurudhor.

Neni 2 Përjashtime nga fusha e zbatimit

1. Transportet në të cilat stacioni i nisjes dhe stacioni i mbërritjes janë të vendosura në territorin e një shteti të vetëm dhe që përshkojnë territorin e një shteti tjetër veçse në transit, nuk i nënshtrohen rregullave uniforme:

a) nëse linjat në të cilat kryhet transiti shfrytëzohen ekskluzivisht nga një hekurudhë e shtetit të nisjes ose

b) nëse shtetet ose hekurudhat e interesuara kanë vendosur për të mos i konsideruar këto transporte si ndërkombëtare.

2. Transportet midis stacioneve të dy shteteve kufitare dhe transportet midis stacioneve të dy shteteve në transit me territorin e një shteti të tretë, nëse linjat në të cilat kryhen këto transporte janë të shfrytëzuara ekskluzivisht nga një hekurudhë e njërit nga këto tre shtete dhe që ligjet dhe rregullat e asnjërit prej këtyre shteteve nuk e kundërshtojnë atë, i nënshtrohen regjimit të trafikut të brendshëm të zbatuar nga kjo hekurudhë.

Neni 3 Rezerva lidhur me përgjegjësinë në rast vdekje dhe plagosje të udhëtarëve

1. Çdo shtet anëtar, në momentin kur nënshkruan Konventën ose depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, të pranimit, të aprovimit ose të pjesëmarrjes, mund të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar ndaj udhëtarëve viktime të aksidenteve të ndodhura në territorin e tij tërësinë e dispozitave në lidhje me përgjegjësinë e hekurudhës në rast vdekjeje ose plagosjeje të udhëtarëve, kur këta janë shtetas të tij ose persona që kanë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm në këtë shtet.

2. Çdo shtet që ka bërë rezervën e mësipërme mund të heqë dorë në çdo moment duke informuar për atë qeverinë depozituese. Heqja dorë ndaj rezervës hyn në fuqi një muaj pas datës në të cilën Qeveria Zvicerane ua bën të ditur shteteve.

Neni 4

Detyrimi për të transportuar

1. Hekurudha, në kushtet e rregullave uniforme, detyrohet të kryejë çdo transport të udhëtarëve dhe të bagazheve, mjaft që:

a) udhëtari t'i përshtatet rregullave uniforme, dispozitave plotësuese dhe tarifave ndërkombëtare;

b) transporti të jetë i mundur me personel dhe mjetet normale të transportit, që lejojnë plotësimin e nevojave të rregullta të trafikut;

c) transporti të mos pengohet nga rrethana që hekurudha nuk mund t'i mënjanojë dhe për të cilat nuk varet nga ajo që t'i ndreqë.

2. Kur autoriteti kompetent ka vendosur që shërbimi të hiqet ose të pezullohet në tërësi ose në veçanti, këto masa duhet t'i njoftohen pa vonesë publikut dhe hekurudhave; këto të fundit për ato informojnë shtetet e tjera, me qëllim publikimin e tyre.

3. Çdo shkelje e kryer nga hekurudha ndaj këtij neni mund t'i japë vend një padie për dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara.

DCU

Në rastin e ndarjes së infrastrukturës hekurudhore dhe të shfrytëzimit të shërbimeve të transportit hekurudhor, detyrimi për të transportuar ka parasysh vetëm hekurudhën që i ofrohet për të transportuar ose që është caktuar nga shteti, për aq sa e drejta kombëtare nuk ka vendosur ndryshe.

Neni 5

Tarifat, marrëveshjet e veçanta

1. Tarifat ndërkombëtare duhet të përmbajnë të gjitha kushtet speciale të zbatueshme në transport, sidomos elementet e domosdoshme për llogaritjen e çmimit të transportit dhe të shpenzimeve ndihmëse dhe, në rast se duhet, kushtet e konvertimit të monedhave.

Kushtet e tarifave ndërkombëtare mund të kundërshtojnë rregullat uniforme vetëm nëse ato e parashikojnë atë shprehimisht.

2. Tarifat ndërkombëtare duhet të zbatohen nga të gjithë në të njëjtat kushte.

3. Hekurudhat mund të përfundojnë marrëveshje të veçanta që përmbajnë zbritje të çmimit ose avantazhe të tjera, në kuptimin kur kushte të krahasueshme pranohen ndaj udhëtarëve që gjenden në situata të krahasueshme.

Zbritje të çmimit ose avantazhe të tjera mund të jepen për shërbimin hekurudhor, për shërbimin e administratave publike ose për punonjës të ndihmave, të edukimit dhe të instruksionit.

Publikimi i masave të mara sipas kryeradhës së parë dhe të dytë nuk është i detyrueshëm

4. Publikimi i tarifave ndërkombëtare është i detyrueshëm vetëm në shtetet, hekurudhat e të cilave marrin pjesë në këto tarifa si rrjetë të nisjes ose të mbërritjes. Këto tarifa dhe modifikimet e tyre hyjnë në fuqi në datën e treguar në kohën e publikimit të tyre. Shtesat e çmimeve dhe dispozitat e tjera që do të kishin për efekt dhënien e kushteve më rigorozë të transportit të parashikuara nga këto tarifa hyjnë në fuqi jo më shpejt se gjashtë ditë pas publikimit të tyre.

Modifikimet e bëra ndaj çmimit të transportit dhe të shpenzimeve ndihmëse të parashikuara në tarifat ndërkombëtare për të mbajtur parasysh flukset e ndryshimit, si dhe korrigjimet e gabimeve të manifestuara hyjnë në fuqi të nesërmen e publikimit të tyre.

5. Në çdo stacion të hapur për trafikun ndërkombëtar, udhëtari mund të marrë njohuri për tarifat ndërkombëtare ose për përmbledhje të tyre, që tregojnë çmimet e biletave ndërkombëtare që aty janë në shitje dhe taksat korresponduese për bagazhet.

Neni 6

Njësia e llogarisë, kurset e konvertimit ose të pranimi të monedhave

1. Njësia e llogarisë, e parashikuar nga rregullat uniforme, është e drejta e tirazhit special siç përcaktohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në të drejtën e tirazhit special, vlera e monedhës kombëtare të një shteti anëtar të Fondit Monetar Ndërkombëtar llogaritet sipas metodës së vlerësimit të zbatuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për operacionet dhe transaksionet e veta.

2. Në të drejtën e tirazhit special, vlera e monedhës së një shteti joanëtar të Fondit Monetar Ndërkombëtar, llogaritet sipas mënyrës së përcaktuar nga ky shtet.

Kjo llogaritje duhet të shprehë në monedhën kombëtare një vlerë reale sa më të përafërt që të jetë e mundur me atë që do të rezultonte nga zbatimi i pikës 1.

3. Për një shtet joanëtar të Fondit Monetar Ndërkombëtar, legjislacioni i të cilit nuk lejon zbatimin e pikës 1 ose të pikës 2, njësia e llogarisë e parashikuar nga rregullat uniforme konsiderohet si të jetë e barabartë me tre franga ari.

Franga e arit përcaktohet nga 10/31 e gramit ar me titull 0.900.

Kthimi i frangave të arit duhet të shprehë në monedhën kombëtare një vlerë reale sa më të përafërt që të jetë e mundur me atë që do të rezultonte nga zbatimi i pikës 1.

4. Shtetet, gjatë tre muajve që vijojnë hyrjen në fuqi të Konventës dhe çdo herë që kryhet një ndryshim në metodën e tyre të llogaritjes ose në vlerën e monedhës kombëtare në raport me njësinë e llogarisë, i komunikojnë Zyrës Qendrore metodën e tyre të llogaritjes konform pikës 2 ose rezultateve të kthimit konform pikës 3.

Zyra Qendrore ia njofton këto informacione shteteve.

5. Hekurudha duhet të publikojë kurset, me të cilat:

a) ajo kryen konvertimin e shumave të shprehura në njësi monetare të huaja, të pagueshme në monedhën e vendit (kurset e konvertimit);

b) ajo pranon në pagimin e monedhave të huaja (kurset e pranimi).

DCU

Kur zbatimi i detyrimeve që rezultojnë nga kontrata e transportit kërkon konvertimin e një monedhe, kursi i konvertimit që duhet përdorur është ai që është në fuqi ditën kur kryhet konvertimi.

Hekurudha e ngarkuar për konvertimin cakton kursin që duhet të publikohet në një mënyrë të përshtatshme.

Neni 7

Dispozitat plotësuese

1. Dy ose më shumë shtete ose dy ose më shumë hekurudha mund të hartojnë dispozita plotësuese për zbatimin e rregullave uniforme. Këto mund të kundërshtojnë rregullat uniforme vetëm nëse ato e parashikojnë atë shprehimisht.

2. Dispozitat plotësuese hyjnë në fuqi dhe publikohen në format e parashikuara nga ligjet dhe rregullat e çdo shteti. Dispozitat plotësuese dhe hyrja e tyre në fuqi i komunikohen Zyrës Qendrore.

Neni 8

E drejta kombëtare

1. Në mungesë të dispozitave në rregullat uniforme, në dispozitat plotësuese dhe në tarifatat ndërkombëtare, zbatohet e drejta kombëtare.

2. Me të drejtë kombëtare kuptohet e drejta e shtetit ku ai që ka të drejtën ushtron të drejtat e tij, duke përfshirë aty rregullat në lidhje me konfliktet ligjore.

3. Për zbatimin e dispozitave në lidhje me përgjegjësinë e hekurudhës në rast vdekje ose plagosje të udhëtarëve, e drejta kombëtare është ajo e shtetit në territorin e të cilit ka ndodhur aksidenti ndaj udhëtarit, duke përfshirë aty rregullat ndaj konflikteve gjyqësore.

KREU II KONTRATA E TRANSPORTIT

KAPITULLI I TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 9

Oraret dhe përdorimi i trenave

1. Hekurudha duhet t'ia bëjë të njohur publikut orarin e trenave në mënyrën e përshtatshme.
2. Oraret ose tarifat duhet të tregojnë kufizimet në përdorimin e disa trenave ose të disa klasave të vagonave.

Neni 10

Përfshirja nga transporti, pranimi me kushte

1. Përfshihen nga transporti ose mund të përfshihen gjatë udhëtimit:
 - a) personat në gjendje të dehur, ata që sillen në mënyrë të pahijshme ose që nuk respektojnë dispozitat në fuqi në çdo shtet; këta persona nuk kanë të drejtën e kthimit as të biletës së tyre, as të çmimit që ata kanë paguar për transportin e bagazheve të tyre;
 - b) personat që, për arsye të një sëmundjeje ose për shkaqe të tjera, do të shqetësonin fqinjët e tyre, me kusht që për këta të mos jetë rezervuar një kompartiment i tërë ose të mos jetë vënë në dispozicionin e tyre kompartimenti kundrejt pagesës. Megjithatë, personat që mund të sëmurën gjatë udhëtimit duhet të transportohen të paktën deri në stacionin e parë, në të cilin është e mundur t'i jepen kujdesjet e nevojshme; çmimi i udhëtimit iu kthehet atyre në përputhje me nenin 25, pas zbritjes së pjesës që lidhet me udhëtimin e kryer; në rast se duhet, po ashtu veprohet dhe për transportin e bagazheve.
2. Transporti i personave të prekur nga sëmundje ngjithëse përcaktohet nga konventat dhe rregullat ndërkombëtare ose në mungesë të tyre nga ligjet dhe rregullat e çdo shteti.

Neni 11

Biletat

1. Biletat që jepen për një transport ndërkombëtar duhet të përmbajnë shenjë CIV. Përkohësisht pranohet shenja Ç.
2. Tarifat ndërkombëtare ose marrëveshjet midis hekurudhave përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e biletave, si dhe gjuhën dhe shkronjat në të cilat ato duhet të shtypen dhe të plotësohen.
3. Përveç përfshimit të parashikuar në tarifat ndërkombëtare, biletat duhet të përmbajnë:
 - a) stacionet e nisjes dhe të mbërritjes;
 - b) itinerarin; nëse lejohet përdorimi i itinerareve të ndryshme ose i mjeteve të ndryshme, kjo mundësi duhet të shënohet;
 - c) kategorinë e trenit dhe klasën e vagonit;
 - d) çmimin e transportit;
 - e) ditën e parë të vlefshmërisë;
 - f) kohëzgjatjen e vlefshmërisë.
4. Blloqet e kuponave të dhëna mbi bazën e një tarife ndërkombëtare përbëjnë një biletë të vetme sipas rregullave uniforme.
5. Përveç përfshimit të parashikuar nga tarifat ndërkombëtare, bileta mund t'i lihet një personi tjetër nëse në të nuk është shënuar emri dhe nëse udhëtimi nuk ka filluar.

6. Me marrjen e biletës, udhëtari duhet të sigurohet që ajo është plotësuar sipas treguesve të saj.

7. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së biletave dhe ndalesat gjatë rrugës rregullohen nga tarifat ndërkombëtare.

Neni 12

E drejta e transportit; udhëtimi pa biletë të vlefshme

1. Që në fillim të udhëtimit, udhëtari duhet të pajiset me një biletë të vlefshme; ai duhet ta ruajë atë gjatë gjithë udhëtimit dhe, nëse kërkohet, t'ia paraqesë atë çdo punonjësi të hekurudhës të ngarkuar për kontrollin dhe ta kthejë atë në fund të udhëtimit. Tarifat ndërkombëtare mund të parashikojnë përjashtime.

2. Biletat që kanë pësuar një ndryshim të palejueshëm nuk janë të vlefshme, dhe tërhiqen nga punonjësit e hekurudhës të ngarkuar për kontroll.

3. Udhëtari që nuk mund të paraqesë një biletë të vlefshme duhet të paguajë, përveç çmimit të transportit, një mbitaksë të llogaritur në përputhje me rregullat e zbatueshme nga hekurudha që kërkon pagimin e mbitaksës.

4. Udhëtari që refuzon pagimin e menjëhershëm të çmimit të transportit ose të mbitaksës mund të përjashtohet nga transporti. Udhëtari i përjashtuar nuk mund të kërkojë që bagazhet e tij t'i vihen në dispozicion në një stacion tjetër nga stacioni i mbërritjes.

Neni 13

Reduktimi i çmimit për fëmijët

1. Fëmijët deri në moshën pesë vjeç, për të cilët nuk është zënë një vend i veçantë transportohen falas dhe pa biletë.

2. Fëmijët me moshë mbi pesë vjeç e deri në dhjetë vjeç dhe fëmijët më të vegjël, për të cilët kërkohet një vend i veçantë transportohen me çmime të reduktuara. Këto nuk mund të kalojnë gjysmën e çmimeve të marra për biletat e të rriturve, veçse kur është fjala për shtesat e marra për përdorimin e disa trenave ose të disa vagonave, duke ruajtur të drejtën e rrumbullakimit të shumave të kryer në përputhje me dispozitat e zbatueshme nga hekurudha që lëshon biletën.

Ky reduktim nuk është detyrues i zbatueshëm ndaj çmimeve të biletave që përmbajnë një reduktim tjetër në raport me çmimin normal të biletës së thjeshtë.

3. Megjithatë, tarifat ndërkombëtare mund të parashikojnë kufij moshash të ndryshme me ato të pikave 1 dhe 2, në masën kur këto kufij nuk janë më të vegjël se katër vjeç, përsa i përket dhënies falas të transportit të përmendur në pikën 1, as se dhjetë vjeç në rastin e zbatimit të çmimeve të reduktuara të përmendura në pikën 2.

Neni 14

Zënia e vendeve

1. Zënia, caktimi dhe rezervimi i vendeve në trena rregullohen nga dispozitat e zbatueshme nga hekurudha. Për transportin e mjeteve automobilistike, hekurudha mund të parashikojë që udhëtarët të qëndrojnë në automjete gjatë transportit.

2. Në kushtet e përcaktuara nga tarifat ndërkombëtare, udhëtari mund të përdorë një vend të një klase më të lartë ose një tren me kategori çmimi më të lartë se ajo e shënuar mbi biletë ose të bëjë modifikimin e itinerarit.

Neni 15

Futja e kolive të dorës dhe të kafshëve në vagona

1. Udhëtari mund të marrë falas me vete në vagona objekte të lehta për t'u mbajtur (koli dore).

Çdo udhëtar ka në dispozicion për kolitë e tij të dorës vetëm një hapësirë të vendosur mbi dhe nën vendin që ai zë, ose një hapësirë tjetër korresponduese kur vagonat janë të një tipi special, sidomos kur ato përmbajnë një depo për bagazhet.

2. Nuk mund të futen në vagona:

a) lëndët dhe objektet e përjashtuara nga transporti si bagazhe sipas nenit 18, e) përveç përjashtimeve të parashikuara nga dispozitat plotësuese ose tarifit;

b) objektet e një natyre që shqetësojnë ose mërzhisin udhëtarët ose shkaktojnë një dëm;

c) objektet që dispozitat e doganës ose të autoriteteve të tjera administrative nuk lejojnë hyrjen në vagona;

d) kafshët e gjalla, përveç përjashtimeve të parashikuara nga dispozitat plotësuese ose tarifit.

3. Tarifat ndërkombëtare mund të parashikojnë se në cilat kushte objektet e futura në vagona në kundërshtim me pikat 1 dhe 2b) transportohen megjithatë si koli dore ose si bagazhe.

4. Hekurudha, në prani të udhëtarit, ka të drejtën të sigurohet për natyrën e objekteve të futura në vagona në rast se supozohet një shkelje e rëndë e pikave 2a), b) dhe d). Nëse nuk është e mundur që të identifikohet udhëtari që ka marrë me vete objektet që i nënshtrohen verifikimit, hekurudha e kryen atë në prani të dy dëshmitarëve që nuk kanë lidhje me hekurudhën.

5. Mbikëqyrja e objekteve dhe e kafshëve që udhëtari mer me vete në vagon i takon udhëtarit, përveçse kur ai nuk mund ta bëjë këtë sepse ndodhet në një vagon të tipit special të përmendur në pikën 1.

6. Udhëtari është përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara nga objektet ose kafshët që ai merr me vete në vagon, përveç kur ai provon që dëmi është shkaktuar nga një gabim i hekurudhës, nga një gabim i një të treti ose nga rrethana që udhëtari nuk mund t'i mënjanojë dhe pasojat e të cilave nuk mund t'i parandalonte.

Kjo dispozitë nuk prek përgjegjësinë që mund t'i takojë hekurudhës sipas nenit 26.

Neni 16

Korrespondenca e munguar, heqja e trenave

1. Kur për shkak të një vonese të një treni, korrespondenca me një tren tjetër nuk është realizuar ose kur një tren është pezulluar për të gjithë udhëtimin ose për një pjesë të tij dhe që udhëtari dëshiron të vazhdojë udhëtimin e tij, atëherë hekurudha duhet të nisë udhëtarin me kolitë e tij të dorës dhe me bagazhet e tij, në masën që është e mundur dhe pa asnjë mbitaksë, me një tren që drejtohet drejt të njëjtit stacion të mbërritjes, nëpër të njëjtën linjë ose me një linjë tjetër që lidhet me hekurudhat pjesëmarrëse në itinerarin e transportit të mëparshëm, në mënyrë që t'i lejojë udhëtarit të mbërrijë në destinacion më sa më pak vonesë.

2. Nëse ka vend, hekurudha duhet të vërtetojë në biletë që korrespondenca ka munguar ose që treni është pezulluar, të zgjasë vlefshmërinë e biletës në masën e nevojshme dhe ta bëjë të vlefshme për itinerarin e ri, për një klasë më të lartë ose për një tren të një kategorie me çmim më të lartë. Megjithatë, tarifit ose oraret mund të përjashtojnë përdorimin e disa trenave.

KAPITULLI II

TRANSPORTI I BAGAZHEVE

Neni 17

Objektet e pranuar

1. Pranohen në transport si bagazhe objektet e caktuara për qëllime udhëtimi që ndodhen në baule, shporta, valixhe, çanta udhëtimi dhe në ambalazhe të tjera të këtij lloji, si dhe vetë ambalazhet.

2. Tarifit ndërkombëtare mund të pranojnë si bagazhe nën disa kushte të veçanta kafshë dhe objekte që nuk përmenden në pikën 1, si dhe mjete automobilistike të dorëzuara në transport me ose pa rimorkio.

Kushtet e transportit të mjeteve automobilistike saktësojnë në veçanti kushtet e pranimit për transport, të regjistrimit, të ngarkimit dhe të transportit, formën dhe përmbajtjen e dokumentit të transportit që duhet të përmbajë shenjën CIV, kushtet e shkarkimit dhe të dorëzimit, si dhe detyrimet e shoqëruesit në lidhje me mjetin e tij, ngarkimin dhe shkarkimin.

Neni 18

Objektet e përjashtuara

Përjashtohen nga transporti si bagazhe:

- a) objektet, transporti i të cilave është i ndaluar, qoftë dhe në njërin prej territoreve që duhen përshkruar nga bagazhet;
- b) objektet, transporti i të cilave i rezervohet administratës së postave, qoftë dhe në njërin nga territoret që duhen përshkruar nga bagazhet;
- c) mallrat e destinuara për tregti;
- d) objektet kaba ose me një masë të madhe;
- e) lëndët dhe objektet e rrezikshme, sidomos armët e mbushura, lëndët dhe objektet eksplozive ose që ndizen, lëndët djegëse, toksike, radioaktive ose korrozive, si dhe lëndët me erë të keqe ose infektive; tarifat ndërkombëtare mund të pranojnë si bagazhe me disa kushte disa nga këto lëndë dhe objekte.

Neni 19

Regjistrimi dhe transporti i bagazheve

1. Përveç ndonjë përjashtimi të parashikuar në tarifat ndërkombëtare, regjistrimi i bagazheve bëhet vetëm me paraqitjen e biletave të vlefshme të paktën deri në destinacionin e bagazheve.

Kur tarifat parashikojnë që bagazhet mund të pranohen në transport pa paraqitjen e biletave, dispozitat e rregullave uniforme që fiksojnë të drejtat dhe detyrimet e udhëtarit lidhur me bagazhet e tij zbatohen për analogji ndaj nisësit të bagazheve.

2. Hekurudha rezervon mundësinë e lëvizjes së bagazheve në një itinerar të ndryshëm nga ai i përshkruar nga udhëtari.

Në stacionin e nisjes, ashtu dhe në stacionet e korrespondencës ku bagazhi duhet të ndërrojë tren, lëvizja bëhet me trenin e parë të përshtatshëm që siguron transportin e rregullt të bagazheve.

Lëvizja e bagazheve mund të bëhet në kushtet e treguara më lart, veçse nëse formalitetet e kërkuara në nisje ose në udhëtim nga doganat, ose nga autoritetet e tjera administrative nuk i kundërshtojnë ato.

3. Përveç ndonjë përjashtimi të parashikuar nga tarifat ndërkombëtare, çmimi i transportit të bagazheve duhet të paguhet në kohën e regjistrimit.

4. Tarifat ose oraret mund të përjashtojnë ose të kufizojnë transportin e bagazheve në disa trena ose në disa kategori të trenave ose me destinacion dhe ardhje nga disa stacione.

5. Formalitetet e regjistrimit të bagazheve, të papërcaktuara nga ky nen rregullohen nga dispozitat në fuqi në stacionin e ngarkuar për regjistrimin.

Neni 20

Buletini i bagazheve

1. Gjatë regjistrimit të bagazheve, udhëtarit i jepet një buletin.

2. Buletini i bagazheve që jepet për një transport ndërkombëtar duhet të përmbajë shenjë CIV. Për një fazë tranzitore pranohet shenja C.

3. Tarifat ndërkombëtare ose marrëveshjet midis hekurudhave përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e buletineve të bagazheve, si dhe gjuhën dhe shkronjat me të cilat duhet të shtypen dhe plotësohen.

4. Përveç përjashtimit të parashikuar nga tarifat ndërkombëtare, buletinet duhet të përmbajnë:

- a) stacionet e nisjes dhe të mbërritjes;
- b) itinerarin;
- c) ditën dhe orën e dorëzimit;
- d) numrin e udhëtarëve;
- e) numrin dhe masën e kolive;

f) çmimin e transportit dhe shpenzimet e tjera.

5. Me pranimin e buletinit të bagazheve, udhëtari duhet të sigurohet që ky është përpiluar sipas treguesve të tij.

Neni 21

Gjendja, kushtet, ambalazhimi dhe shenjat e bagazheve

1. Kolitë, gjendja ose paketimi i të cilave është defektoz ose ambalazhimi është i pamjaftueshëm ose që paraqesin shenja të dukshme dëmtimi, mund të refuzohen nga hekurudha. Nëse megjithatë ajo i pranon ato, ajo duhet të bëjë një shënim të përshtatshëm në buletin e bagazheve. Pranimi i buletinit të bagazheve nga udhëtari që përmban një shënim të tillë konsiderohet si provë që udhëtari ka njohur saktësinë e këtij shënimi.

2. Udhëtari duhet të shënojë mbi çdo koli, në një vend që shihet mirë, në kushtet e një fiksimit të mjaftueshëm, në një mënyrë të qartë dhe me shkronja të pafshirshme që të mos lejojnë asnjë keqkuptim:

a) emrin dhe adresën e tij,

b) stacionin dhe vendin e mbërritjes.

Shënimet e pavlefshme duhet të bëhen të palexueshme ose të hiqen nga udhëtari.

Hekurudha mund të refuzojë kolitë që nuk përmbajnë shënimet e përcaktuara.

Neni 22

Përgjegjësia e udhëtarit, verifikimi, mbitaksa

1. Udhëtari është përgjegjës për të gjitha pasojat e mosrespektimit të neneve 17, 18 dhe 21 pika 2.

2. Në rast prezumimi të një kundërvajtjeje të rëndë, hekurudha ka të drejtën të verifikojë nëse përmbajtja e bagazheve i përgjigjet dispozitave kur ligjet dhe rregulloret e shtetit ku bëhet verifikimi nuk e ndalojnë atë. Udhëtari duhet të ftohet për të marrë pjesë në verifikim. Nëse ai nuk paraqitet ose nëse nuk mund të merret kontakt me të, verifikimi duhet të bëhet në prani të dy dëshmitarëve që s'kanë të bëjnë me hekurudhën.

3. Nëse konstatohet një shkelje, udhëtari duhet të paguajë shpenzimet e shkaktuara nga verifikimi.

Në rast shkelje të neneve 17 dhe 18, hekurudha mund të marrë një mbitaksë të caktuar nga tarifat ndërkombëtare, pa hequr dorë nga pagimi i diferencës së çmimit të transportit dhe të një dëmshpërblimi për dëmin e mundshëm.

Neni 23

Dorëzimi

1. Dorëzimi i bagazheve bëhet kundrejt dorëzimit të buletinit të bagazheve dhe, në rast se duhet, përkundrejt pagimit të shpenzimeve që rëndojnë dërgesën. Hekurudha ka të drejtën, pa e pasur për detyrë, të verifikojë nëse mbajtësi i buletinit ka të drejtën për ta marrë në dorëzim.

2. Janë të ngjashme me dorëzimin ndaj mbajtësit të buletinit, kur kryhen konform dispozitave në fuqi në stacionin e ngarkuar për dorëzim:

a) dorëzimi i bagazheve autoriteteve të doganës ose të taksave në lokalet e tyre të speditonit ose në depot e tyre, kur këto nuk gjenden nën ruajtjen e hekurudhës;

b) fakti për t'i besuar kafshët e gjalla një të treti.

3. Mbajtësi i buletinit mund t'i kërkojë zyrës së dorëzimit të stacionit mbërritës dorëzimin e bagazheve sapo ato të jenë gati, pas mbërritjes së trenit me të cilin bagazhet janë transportuar, pas kohës së nevojshme për vënien në dispozicion, si dhe, në rast se duhet, pas plotësimit të formaliteteve të kërkuara nga doganat ose autoritetet e tjera administrative.

4. Në mungesë të dorëzimit të buletinit, hekurudha detyrohet t'i dorëzojë bagazhet vetëm atij që justifikon të drejtën e tij; nëse ky justifikim duket i pamjaftueshëm, hekurudha mund të kërkojë një garanci.

5. Bagazhet dorëzohen në stacionin për të cilin janë regjistruar. Megjithatë, me kërkesën e mbajtësit të buletinit, të bërë në kohën e duhur, nëse rrethanat e lejojnë dhe nëse dispozitat e doganës ose të autoriteteve të tjera administrative nuk e kundërshtojnë, bagazhet mund të kthehen në stacionin e nisjes ose të dorëzohen në një stacion të ndërmjetëm kundrejt dorëzimit të buletinit të bagazheve dhe, përveç kësaj, nëse tarifat e kërkojnë, kundrejt paraqitjes së biletës.

6. Mbajtësi i buletinit, të cilit bagazhet nuk i janë dorëzuar konform pikës 3, mund të kërkojë konstatimin, në buletin, të ditës dhe orës, në të cilat ai ka kërkuar dorëzimin.

7. Nëse kërkohet nga ai që ka të drejtën, hekurudha duhet të veprojë në prezencë të tij për verifikimin e bagazheve, me qëllim që të konstatojë një dëm, të cilit ai i referohet. Ai që ka të drejtën mund të refuzojë pranimin e bagazheve nëse hekurudha nuk i përgjigjet kërkesës së tij.

8. Për më tepër, dorëzimi i bagazheve kryhet konform dispozitave në fuqi në stacionin e ngarkuar për dorëzimin.

DCU

1. Treni me të cilin bagazhet duhej të transportoheshin përcaktohet nga mundësitë e nisjes sipas orarit, në funksion të ditës dhe orës së dorëzimit.

KAPITULLI III

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE E TË BAGAZHEVE

Neni 24

Plotësimi i formaliteteve administrative

Udhëtari duhet të veprojë në përputhje me dispozitat e doganës ose autoriteteve të tjera administrative si përsa i përket personit të tij dhe kafshëve që merr me vete, ashtu dhe për kontrollin e kolive të tij të dorës dhe të bagazheve. Ai duhet të jetë i pranishëm në këtë kontroll, përveç ndonjë përjashtimi të parashikuar nga ligjet dhe rregulloret e çdo shteti. Hekurudha nuk është përgjegjëse kundrejt udhëtarit për dëmin që rezulton nga fakti që udhëtari nuk mban parasysh këto detyrime.

Neni 25

Rimbursimi, kthimi dhe pagesa shtesë

1. Çmimi i transportit rimbursohet në tërësi ose pjesërisht kur:

a) bileta nuk është përdorur ose është përdorur pjesërisht;

b) për shkak të mungesës së vendit, bileta është përdorur në një klas ose në një tren të një kategorie me çmim më të ulët se ajo e shënuar në biletë;

c) bagazhet janë tërhequr në stacionin e nisjes ose dorëzuar në një stacion të ndërmjetëm;

2. Tarifat ndërkombëtare fiksojnë dokumentet dhe vërtetimet që duhen paraqitur në mbështetje të kërkesës së rimbursimit, shumat për t'u rimbursuar, si dhe taksat që duhen zbritur prej tyre.

Në raste të përcaktuara këto tarifa mund të përjashtojnë rimbursimin e çmimit të transportit ose ta vënë atë në vartësi të disa kushteve.

3. Çdo kërkesë rimbursimi që bazohet në paragrafët e mëparshëm dhe në nenin 10, pika 1, b) është e papranueshme nëse ajo nuk i është paraqitur hekurudhës brenda 6 muajve. Për biletat, afati fillon nga dita që vijon mbarimin e vlefshmërisë së tyre dhe për buletinet e bagazheve, nga dita e lëshimit të tyre.

4. Në rast të zbatimit të parregullt të një tarife ose të një gabimi në llogaritjen ose në marrjen e çmimit të transportit dhe të shpenzimeve të tjera, shuma e marrë tepër kthehet nga hekurudha ose shuma e marrë mangut i derdhet asaj vetëm nëse diferenca i kalon 2 njësi llogarie për biletë ose për buletin të bagazheve.

5. Për llogaritjen e shumës së marrë tepër ose të asaj të marrë mangut duhet të zbatohet kursi i këmbimit zyrtar në ditën kur është marrë çmimi i transportit. Nëse pagesa për të është kryer në një monedhë tjetër nga ajo e monedhës së marrjes, kursi që zbatohet është ai në ditën ku kjo pagesë është kryer.

6. Në çdo rast të pa parashikuar nga ky nen dhe në mungesë të marrëveshjeve ndërmjet hekurudhave janë të zbatueshme dispozitat në fuqi në shtetin e nisjes.

KREU III PËRGJEGJËSIA

KAPITULLI I PËRGJEGJËSIA E HEKURUDHËS NË RAST VDEKJE DHE PLAGOSJE TË UDHËTARËVE

Neni 26

Bazat e përgjegjësisë

1. Hekurudha është përgjegjëse për dëmin që rezulton nga vdekja, plagosja ose nga çdo cenim i tërësisë fizike ose mendore të një udhëtari të shkaktuar nga një aksident që lidhet me shfrytëzimin hekurudhor të ndodhur gjatë kohës që udhëtari qëndron në vagon, që ai hyn aty ose kur del prej andej.

Përveç kësaj hekurudha është përgjegjëse për dëmin që rezulton nga humbja e plotë ose e pjesshme ose nga dëmtimi i objekteve që udhëtari viktimë i një aksidenti të tillë kishte qoftë mbi vete, qoftë me vete si koli dore, përfshirë aty dhe kafshët.

2. Hekurudha shkarkohet nga kjo përgjegjësi:

a) nëse aksidenti është shkaktuar nga rrethana që s'kanë të bëjnë me shfrytëzimin, të cilat hekurudha, me gjithë gatishmërinë e duhur sipas veçorive të rastit, nuk mund t'i mënjantonë dhe rrjedhojat e të cilave nuk mund t'i parandalonte;

b) tërësisht ose pjesërisht në masën që dëmtimi është shkaktuar nga një gabim i udhëtarit ose nga një sjellje e tij që nuk është në përputhje me sjelljen normale të udhëtarëve;

c) nëse aksidenti është shkaktuar nga sjellja e një të treti që hekurudha, me gjithë gatishmërinë e nevojshme sipas veçorive të rastit, nuk mund ta mënjantonë dhe pasojat e së cilës nuk mund t'i parandalonte; nëse përgjegjësia e hekurudhës nuk përjashtohet nga ky fakt, ajo përgjigjet për gjithçka brenda kufijve të rregullave uniforme dhe pa hequr dorë nga rekursi i saj i mundshëm ndaj të tretëve.

3. Rregullat uniforme nuk caktojnë përgjegjësinë që mund t'i takojë hekurudhës për rastet e pa parashikuara në pikën 1.

4. Hekurudha përgjegjëse në kuptimin e këtij kapitulli është ajo që, sipas listës së linjave të parashikuara në nenet 3 dhe 10 të Konventës, shfrytëzon linjën mbi të cilën aksidenti ka ndodhur. Nëse, sipas kësaj liste, aty ka një bashkëshfrytëzim nga dy hekurudha, secila nga ato është përgjegjëse.

Neni 27

Dëmshpërblimet në rast vdekje

1. Në rast vdekjeje të udhëtarit, dëmshpërblimet përfshijnë:

a) shpenzimet e nevojshme pas vdekjes, sidomos ato të transportit të kufomës, të varrosjes dhe të djegies;

b) dëmshpërblimet e parashikuara në nenin 28, nëse vdekja nuk ka ndodhur menjëherë.

2. Nëse nga vdekja e udhëtarit, personat kundrejt të cilëve ai kishte ose do të kishte në të ardhmen, në bazë të ligjit, një detyrim ushqimor dhe ata privohen nga mbështetjet e tyre, atëherë duhet gjithashtu që ata të dëmshpërblehen nga kjo humbje. Padia e personave për dëmshpërblimet ndaj të cilëve udhëtari kishte marrë përsipër mbajtjen e tyre pa qenë i detyruar nga ligji, mbetet t'i nënshtrohet së drejtës kombëtare.

Neni 28

Dëmshpërblimet në rast plagosje

Në rast plagosje ose të çdo lloj cenimi tjetër të tërësisë fizike ose mendore të udhëtarit, dëmshpërblimet përfshijnë:

- a) shpenzimet e nevojshme, sidomos ato të trajtimit dhe të transportit;
- b) shlyerjen e dëmit të shkaktuar, qoftë nga paaftësia e plotë ose e pjesshme në punë, qoftë nga rritja e nevojave.

Neni 29

Shlyerja e dëmeve të tjera

E drejta kombëtare përcakton nëse dhe në cilën masë hekurudha duhet të derdhë dëmshpërblimet për dëme të tjera nga ato të parashikuara në nenet 27 dhe 28, sidomos dëmet morale dhe fizike (*pretium doloris*) dhe estetike.

Neni 30

Forma dhe kufizimi i dëmshpërblimeve në rast vdekje dhe plagosje

1. Dëmshpërblimet e parashikuara në nenet 27 pika 2 dhe 28 b) duhet të jepen në formë kapitali. Megjithatë, nëse e drejta kombëtare lejon dhënien e një rente, ato jepen në këtë formë kur udhëtari i dëmtuar ose ata që kanë të drejtën ligjërisht sipas nenit 27, pika 2 e kërkojnë.

2. Shuma e dëmshpërblimeve që jepet sipas pikës 1 përcaktohet sipas të drejtës kombëtare. Megjithatë, për zbatimin e rregullave uniforme, caktohet një kufi maksimal prej 70 000 njësi llogarie në kapital ose në rentë vjetore që i korrespondon këtij kapitali, për çdo udhëtar, në rastin kur e drejta kombëtare parashikon një kufi maksimal të një shume më të vogël.

Neni 31

Kufizimi i dëmshpërblimeve në rast humbje ose dëmtimi të objekteve

Kur hekurudha është përgjegjëse sipas nenit 26, pika 1 kryeradha e dytë, dëmi duhet të shlyhet deri në masën prej 700 njësi llogarie për çdo udhëtar.

Neni 32

Ndalimi për të kufizuar përgjegjësinë

Dispozitat tarifore dhe ato të marrëveshjeve të veçanta të përfunduara midis hekurudhës dhe udhëtarit, që synojnë ta përjashtojnë paraprakisht, tërësisht ose pjesërisht hekurudhën nga përgjegjësia e saj në rast vdekje ose plagosje të udhëtarëve ose që kanë për qëllim të rrëzojnë barrën e provës që i takon hekurudhës ose që vendosin kufij më të ulët se ato të fiksuara në nenet 30 pika 2 dhe 31, nuk janë aspak të drejta të plota. Megjithatë ky nulitet nuk lidhet me atë të kontratës së transportit.

Neni 33

Transportet e përziera

1. Nën rezervën e pikës 2, dispozitat lidhur me përgjegjësinë e hekurudhës në rast vdekje ose plagosje të udhëtarëve nuk janë të zbatueshme për dëmet që ndodhin gjatë transportit në linjat jo hekurudhave të pa regjistruara në listën e linjave të parashikuara në nenet 3 dhe 10 të Konventës.

2. Megjithatë, kur mjetet hekurudhore transportohen me tragete, dispozitat në lidhje me përgjegjësinë e hekurudhës në rast vdekje dhe plagosje të udhëtarëve zbatohen për dëmet e nënvizuara në nenin 26, pika 1, të shkaktuara nga një aksident në lidhje me shfrytëzimin hekurudhor të ndodhur gjatë kohës që udhëtari qëndron në mjetet në fjalë, kur hyn në to ose del prej andej.

Për zbatimin e paragrafit të mësipërm, me “Shtet në territorin e të cilit është shkaktuar aksidenti ndaj udhëtarit” kuptojmë shtetin, flamurin e të cilit mban trageti.

3. Kur në vijim të rrethanave të veçanta hekurudha ndodhet e detyruar të ndërpresë përkohësisht shfrytëzimin dhe transportin e saj ose bën që udhëtarët të transportohen me një mjet tjetër transporti, ajo është përgjegjëse sipas të drejtës që lidhet me këtë mjet transporti. Megjithatë, neni 18 i Konventës dhe nenet 8, 48 deri në 53 dhe 55 të rregullave uniforme mbeten të zbatueshme.

KAPITULLI II

PËRGJEGJËSIA E HEKURUDHËS PËR BAGAZHET

Neni 34

Përgjegjësia kolektive e hekurudhave

1. Hekurudha që ka pranuar bagazhet për transport duke dhënë një buletin bagazhi është përgjegjëse për kryerjen e transportit për të gjithë itinerarin e deri në dorëzim.

2. Çdo hekurudhë vijuese, për vetë faktin e marrjes në ngarkim të bagazheve, merr pjesë në kontratën e transportit dhe merr përsipër detyrimet që rezultojnë nga ajo, pa hequr dorë nga dispozitat e nenit 51, pika 3 në lidhje me hekurudhën mbërritëse.

Neni 35

Shtrirja e përgjegjësisë

1. Hekurudha është përgjegjëse për dëmin që rezulton nga humbja tërësore ose pjesore dhe nga dëmtimi i bagazheve që ndodhin, duke filluar që nga pranimi për transport e deri në dorëzim, si dhe për vonesën në dorëzim.

2. Hekurudha shkarkohet nga kjo përgjegjësi nëse humbja, dëmtimi ose vonesa në dorëzim ka pasur për shkak një gabim të udhëtarit, një urdhër të tij që nuk rezulton nga një gabim i hekurudhës, një të metë të bagazheve ose të disa rrethanave që hekurudha nuk mund t'i mënjanonte dhe pasojat e të cilave ajo nuk mund t'i parandalonte.

3. Hekurudha shkarkohet nga kjo përgjegjësi kur humbja ose dëmtimi rezulton nga rreziqe të veçanta që lidhen me një ose me disa nga faktet e mëposhtme:

- a) mungesa ose defekti i ambalazhit;
- b) natyra speciale e bagazheve;
- c) nisja si bagazhe e objekteve të përjashtuara nga transporti.

Neni 36

Detyrimi për provën

1. Prova që humbja, dëmtimi ose vonesa në dorëzim ka pasur për shkak një nga faktet e parashikuara në nenin 35 pika 2, i takon hekurudhës.

2. Kur hekurudha provon që humbja ose dëmtimi, kur janë dhënë rrethanat e faktit, ka rezultuar nga një ose nga disa rreziqe të veçanta të parashikuara në nenin 35 pika 3, atëherë prezumohet që ajo ka rezultuar prej tyre. Megjithatë, ai që ka të drejtën ruan të drejtën që të provojë se dëmi nuk ka pasur për shkak, tërësisht ose pjesërisht, një nga këto rreziqe.

Neni 37

Prezumimi i humbjes së bagazheve

1. Ai që ka të drejtën, pa qenë i detyruar të sjellë prova të tjera, mund të konsiderojë një koli të humbur, kur ajo nuk i dorëzohet ose nuk është mbajtur në dispozicion të tij brenda katërmëdhjetë ditëve që ndjekin kërkesën për dorëzimin të paraqitur në përputhje me nenin 23 pika 3.

2. Nëse një koli e konsideruar si e humbur gjendet gjatë vitit që ndjek kërkesën për dorëzim, hekurudha duhet të njoftojë atë që ka të drejtën kur adresa e tij njihet ose mund të gjendet.

3. Brenda tridhjetë ditëve që ndjekin pranimin e këtij njoftimi, ai që ka të drejtën mund të kërkojë që kolia t'i dorëzohet në një nga stacionet e përshkrimit. Në këtë rast, ai duhet të paguajë shpenzimet që lidhen me transportin e kolisë që nga stacioni i nisjes deri në atë ku bëhet dorëzimi dhe të kthejë dëmshpërblimin e marrë, duke zbritur shpenzimet që do të përfshiheshin në këtë dëmshpërblim. Megjithatë, ai ruan të drejtat e tij për dëmshpërblimin në rastin e vonesës në dorëzim të parashikuar në nenin 40.

4. Nëse kolia e gjendur nuk është reklamuar në afatin e parashikuar në pikën 3 ose nëse kolia gjendet mbas më tepër se një viti pas kërkesës për dorëzim, hekurudha vendos për këtë konform ligjeve dhe rregullave të shtetit ku bën pjesë.

Neni 38

Dëmshpërblimi në rast humbje

1. Në rast humbje tërësore ose pjesore të bagazheve, hekurudha duhet të paguajë, përveç dëmshpërblimeve të tjera:

a) një dëmshpërblim të barabartë me këtë shumë dhe pa mundur megjithatë të kalojë 40 njësi llogarie për kilogram të munguar të masës bruto ose 600 njësi llogarie për koli, nëse shumën e dëmit provohet;

b) një dëmshpërblim të paracaktuar prej 10 njësi llogarie për kilogram të munguar të masës bruto ose 150 njësi llogarie për koli, nëse shumën e dëmit nuk është provuar.

Mënyra e dëmshpërblimit, për kilogram të munguar ose për koli, përcaktohet nga tarifat ndërkombëtare.

2. Përveç kësaj hekurudha duhet të rimbursojë çmimin e transportit, detyrimet doganore dhe shumën e tjera të shpenzuara për rastin e transportit të kolisë së humbur.

Neni 39

Dëmshpërblimi në rast dëmtimi

1. Në rastin e dëmtimit të bagazheve hekurudha duhet të paguajë, përveç të gjitha dëmshpërblimeve të tjera, një dëmshpërblim ekuivalent me zhvlerësimin e bagazheve.

2. Dëmshpërblimi nuk mund të kalojë:

a) shumën që dëmshpërblimi do të arrijë në rastin e humbjes tërësore, nëse tërësia e bagazheve është zhvlerësuar nga dëmtimi;

b) shumën që dëmshpërblimi do të arrijë në rastin e humbjes të pjesës së zhvlerësuar nëse vetëm një pjesë e bagazheve është zhvlerësuar nga dëmtimi.

Neni 40

Dëmshpërblimi në rast vonese në dorëzim

1. Në rastin e vonesës në dorëzimin e bagazheve hekurudha duhet të paguajë, për çdo periudhë të pandashme prej njëzet e katër orësh që fillon nga momenti i kërkesës për dorëzim, por deri në një maksimum prej katërmëdhjetë ditësh:

a) një dëmshpërblim të barabartë me shumën e dëmit deri në një maksimum prej 0.40 njësi llogarie për kilogram të masës bruto të bagazheve ose prej 7 njësi llogarie për koli të dorëzuara me vonesë, nëse ai që ka të drejtën provon që një dëm, përfshirë aty dhe një dëmtim kanë rezultuar nga kjo;

b) një dëmshpërblim të caktuar më parë prej 0.07 njësi llogarie për kilogram të masës bruto të bagazheve ose prej 1.40 njësi llogarie për kolitë e dorëzuara me vonesë, nëse ai që ka të drejtën nuk provon që një dëm ka rezultuar nga kjo.

Mënyra e dëmshpërblimit, për kilogram ose për koli, përcaktohet nga tarifat ndërkombëtare.

2. Në rastin e humbjes tërësore të bagazheve, dëmshpërblimi i parashikuar në pikën 1 nuk mund të mblidhet me atë të nenit 38.

3. Në rastin e humbjes pjesore të bagazheve, dëmshpërblimi i parashikuar në pikën 1 paguhet për pjesën që s'ka humbur.

4. Në rastin e dëmtimit të bagazheve që nuk rezulton nga vonesa në dorëzim, dëmshpërblimi i parashikuar në pikën 1, nëse ka vend, mblidhet me atë të nenit 39.

5. Në asnjë rast, bashkimi i dëmshpërblimit të parashikuar në pikën 1 me ato të neneve 38 dhe 39 nuk mund të lejojë pagesën e një dëmshpërblimi më të madh se ajo që do të duhej në rastin e humbjes tërësore të bagazheve.

Neni 41
Mjetet automobilistike

1. Në rast vonese në ngarkim për një shkak që i vishet hekurudhës ose të një vonese në dorëzim të një mjeti automobilistik, kur ai që ka të drejtën provon që një dëm ka rezultuar nga kjo, atëherë hekurudha duhet të paguajë një dëmshpërblim, shuma e të cilës nuk mund të kalojë çmimin e transportit të mjetit.

2. Nëse ai që ka të drejtën heq dorë nga kontrata e transportit në rastin e vonesës në ngarkim për një shkak që i vishet hekurudhës, çmimi i transportit të mjetit dhe i udhëtarëve i kthehet atij që ka të drejtën. Përveç kësaj, kur provon që një dëm ka rezultuar nga kjo vonesë, ky mund të kërkojë një dëmshpërblim, shuma e të cilit nuk mund të kalojë çmimin të transportit të mjetit.

3. Në rast humbje tërësore ose pjesore të mjetit, dëmshpërblimi që i paguhet atij që ka të drejtën për dëmin e provuar llogaritet sipas vlerës aktuale të mjetit dhe nuk mund të kalojë 8000 njësi llogarie.

4. Përsa i përket objekteve të vendosura në automjete, hekurudha është përgjegjëse vetëm për dëmin e shkaktuar për gabim të saj. Dëmshpërblimi i përgjithshëm për tu paguar nuk mund të kalojë 1000 njësi llogarie.

Hekurudha përgjigjet për objektet e vendosura jashtë automjetit, përveçse në rast mashtrimi.

5. Një rimorkio me ose pa ngarkesë konsiderohet si një mjet.

6. Dispozitat e tjera në lidhje me përgjegjësinë ndaj bagazheve zbatohen edhe për transportin e mjeteve automobilistike.

KAPITULLI III
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA LIDHUR ME PËRGJEGJËSINË

Neni 42
Humbja e të drejtës për t'iu referuar kufijve të përgjegjësisë

Dispozitat e neneve 30, 31 dhe 38 deri në 41 të rregullave uniforme ose ato të parashikuara nga e drejta kombëtare, që kufizojnë dëmshpërblimet ndaj një shume të përcaktuar nuk zbatohen, nëse provohet që dëmi rezulton nga një veprim ose nga një harresë që hekurudha ka kryer, qoftë me qëllimin për të provokuar një dëm të tillë, qoftë nga një iniciativë e tepërt dhe me ndërgjegje që një dëm i tillë do të rezultonte mundësisht nga ajo.

Neni 43
Kthimi dhe interesat e dëmshpërblimit

1. Kur llogaritja e dëmshpërblimit kërkon konvertimin e shumave të shprehura në njësi monetare të huaja, ato kryhen sipas kursit në ditën dhe vendin e pagimit të dëmshpërblimit.

2. Ai që ka të drejtën mund të kërkojë interesa të dëmshpërblimit, të llogaritura me pesë për qind në vit, duke filluar nga dita e reklamimit të parashikuar në nenin 49 ose, nëse nuk ka pasur reklamim, nga dita e kërkesës për gjyq.

3. Megjithatë, për dëmshpërblimet e detyrueshme sipas nenit 27 dhe 28, interesat fillojnë vetëm nga dita kur kanë ndodhur faktet që kanë shërbyer për përcaktimin e shumës së tyre, nëse kjo ditë vjen pas asaj të reklamimit ose të kërkesës për gjyq.

4. Përsa i përket bagazheve, interesat zbatohen vetëm nëse dëmshpërblimi kalon 8 njësi llogarie për buletin të bagazheve

5. Përsa i përket bagazheve, nëse ai që ka të drejtën nuk i dorëzon hekurudhës dokumentet justifikuese të nevojshme për likuidimin përfundimtar të reklamimit, brenda një afati të përshtatshëm që i është caktuar, interesat nuk llogariten midis mbarimit të afatit të caktuar dhe dorëzimit efektiv të dokumenteve.

Neni 44

Përgjegjësia në rast aksidenti bërthamor

Hekurudha shkarkohet nga përgjegjësia që i takon sipas rregullave uniforme kur dëmi është shkaktuar nga një aksident bërthamor dhe që në zbatim të ligjeve dhe të rregullave të një shteti që rregullojnë përgjegjësinë në fushën e energjisë bërthamore, shfrytëzuesi i një instalimi bërthamor ose një person tjetër që ka zëvendësuar atë është përgjegjës për këtë dëm.

Neni 45

Përgjegjësia e hekurudhës për punonjësit e saj

Hekurudha është përgjegjëse për punonjësit e saj dhe për personat e tjerë që ajo punëson për kryerjen e transportit.

Megjithatë, nëse me kërkesë të një udhëtari, këta punonjës dhe personat e tjerë kryejnë shërbime që nuk i takojnë hekurudhës, ata konsiderohen sikur veprojnë për llogari të udhëtarit, të cilit i kryejnë këto shërbime.

Neni 46

Paditë e tjera

Në të gjitha rastet kur zbatohen rregullat uniforme, çdo padi për përgjegjësinë, për çdo arsye qoftë, nuk mund të ushtrohet kundër hekurudhës vetëm në kushtet dhe kufizimet e rregullave në fjalë.

Është e njëjta gjë për çdo padi të ushtruar kundër punonjësve dhe personave të tjerë për të cilët hekurudha përgjigjet në bazë të nenit 45.

Neni 47

Dispozita speciale

1. Në rezervë të nenit 41, përgjegjësia e hekurudhës për dëmet e shkaktuara nga vonesa ose heqja e një treni ose nga një korrespondencë e munguar, mbetet për t'iu nënshtruar ligjeve dhe rregullave të shtetit ku kjo ka ndodhur.

2. Në rezervë të nenit 26, hekurudha është përgjegjëse vetëm për dëmin e shkaktuar nga gabimi i saj, në lidhje me objektet dhe kafshët, mbikëqyrja e të cilave i takon udhëtarit konform nenit 15 pika 5 dhe objekteve që udhëtari ka mbi vehte.

3. Nenet e tjera të kreut III nuk janë të zbatueshme në rastet e pikave 1 dhe 2.

KREU IV

USHTRIMI I TË DREJTAVE

Neni 48

Konstatimi i humbjes pjesore ose i dëmtimit të bagazheve

1. Kur një humbje pjesore ose një dëmtim i bagazheve zbulohet ose prezumohet nga hekurudha ose kur ai që ka të drejtën i referohet egzistencës së saj, hekurudha duhet të hartojë pa vonesë dhe, nëse është e mundur në prani të atij që ka të drejtën një procesverbal që konstaton, sipas natyrës së dëmit, gjendjen e bagazheve, masën e tyre dhe për aq sa është e mundur, rëndësinë e dëmit, shkaku dhe momentin kur ai ka ndodhur.

Një kopje e këtij procesverbali duhet t'i dorëzohet falas atij që ka të drejtën.

2. Kur ai që ka të drejtën nuk i pranon konstatimet e procesverbalit, ai mund të kërkojë që gjëndja dhe masa e bagazheve, si dhe shkaku dhe shuma e dëmit të konstatohen nga një ekspert i emëruar nga palët ose në rrugë gjyqësore. Procedura i nënshtrohet ligjeve dhe rregullave të shtetit ku është kryer konstatimi.

3. Në rastin e humbjes së kolive, ai që ka të drejtën, për të lehtësuar kërkimet e hekurudhës, duhet të japë një përshkrim sa më të saktë që të jetë e mundur për kolitë e humbura.

Neni 49 **Reklamimet**

1. Reklamimet lidhur me përgjegjësinë e hekurudhës në rastin e vdekjes dhe të plagosjes së udhëtarëve duhet t'i adresohen me shkrim një prej hekurudhave vijuese:

a) hekurudhës përgjegjëse, nëse sipas nenit 26 pika 4, dy hekurudha janë përgjegjëse, njëërës prej tyre;

b) hekurudhës së nisjes;

c) hekurudhës mbërritëse;

d) hekurudhës së vendbanimit ose të vendqëndrimit të zakonshëm të udhëtarit, kur selia sociale e kësaj hekurudhe është vendosur në territorin e një shteti anëtar.

2. Reklamimet e tjera në lidhje me kontratën e transportit duhet t'i adresohen me shkrim hekurudhës së caktuar në nenin 51, pikat 2 dhe 3.

Në kohën e trajtimit të reklamimit, hekurudha mund të kërkojë kthimin e biletave ose kthimin e buletineve të bagazheve.

3. E drejta e paraqitjes së një reklamimi i takon personave që kanë të drejtën të padisin hekurudhën sipas nenit 50.

4. Biletat, buletinet e bagazheve dhe dokumentet e tjera që ai që ka të drejtën i gjykon të nevojshme t'ia bashkëlidhë reklamimit duhet të paraqiten qoftë në origjinal, qoftë në kopje dhe këto të fundit të jenë të legalizuara siç duhet, nëse hekurudha e kërkon atë.

Neni 50 **Personat që mund të padisin hekurudhën**

Padia gjyqësore kundër hekurudhës i takon atij që sipas rastit paraqet biletën ose buletin e bagazheve, ose që, në mungesë, justifikon të drejtën e tij në një mënyrë tjetër.

Neni 51 **Hekurudhat që mund të paditen**

1. Padia gjyqësore e bazuar në përgjegjësinë e hekurudhës në rastin e vdekjes ose të plagosjes së udhëtarëve mund të ushtrohet vetëm kundër hekurudhës përgjegjëse, në kuptimin e nenit 26, pika 4. Në rast bashkëshfrytëzimi nga dy hekurudha, paditësi ka të drejtë të zgjedhë midis tyre.

2. Padia gjyqësore për përsëritjen e një shume të paguar sipas kontratës së transportit mund të ushtrohet kundër hekurudhës që ka marrë këtë shumë ose kundër asaj në përfitim të së cilës kjo shumë është marrë.

3. Paditë e tjera gjyqësore që lindin nga kontrata e transportit mund të ushtrohen kundër hekurudhës së nisjes, hekurudhës mbërritëse ose kundër asaj në të cilën ka ndodhur fakti që ka shkaktuar padinë.

Hekurudha mbërritëse mund të paditet edhe nëse ajo nuk ka marrë bagazhet.

4. Nëse paditësi ka bërë zgjedhjen midis shumë hekurudhave, e drejta e tij për zgjedhje shuhet sapo padia është ngritur kundër njëërës prej tyre.

5. Padia gjyqësore mund të ushtrohet kundër një hekurudhe tjetër nga ajo e nënvizuar në pikat 2 dhe 3, kur ajo paraqitet si kërkesë që rrjedh nga një marrëveshje e re ose si një përjashtim në instancën që lidhet me një kërkesë kryesore të bazuar në të njëjtën kontratë transporti.

Neni 52 **Kompetenca**

1. Paditë gjyqësore të bazuara në përgjegjësinë e hekurudhës në rastin e vdekjes dhe të plagosjes së udhëtarëve mund të ngrihen veçse përpara gjykatës kompetente të shtetit në territorin e

të cilit i ka ndodhur aksidenti udhëtarit, kur nuk është vendosur ndryshe për këtë në marrëveshjet midis shteteve ose akteve të koncesionit.

2. Paditë e tjera gjyqësore të bazuara në rregullat uniforme mund të ngrihen vetëm përpara gjykatës kompetente të shtetit ku ndodhet hekurudha e paditur, kur nuk është vendosur ndryshe për këtë në marrëveshjet midis shteteve ose akteve të koncesionit.

Kur një hekurudhë shfrytëzon rrjete autonome në shtete të ndryshme, secili prej këtyre rrjeteve konsiderohet si një hekurudhë e veçantë për zbatimin e këtij paragrafi.

Neni 53

Shuarja e padisë së lindur nga përgjegjësia në rastin e vdekjes dhe të plagosjes së udhëtarëve

1. Çdo padi e atij që ka të drejtën e bazuar në përgjegjësinë e hekurudhës në rastin e vdekjes dhe të plagosjes së udhëtarëve shuhet, nëse ai nuk lajmëron për aksidentin që i ka ndodhur udhëtarit, brenda gjashtë muajve që fillon nga njohja e dëmit, njërën prej hekurudhave të cilave një reklamim i është paraqitur sipas nenit 49 pika 1.

Kur ai që ka të drejtën njofton verbalisht hekurudhën për aksidentin, kjo duhet t'i dorëzojë atij një vërtetim të këtij njoftimi verbal.

2. Megjithatë, padia nuk shuhet nëse:

a) brenda afatit të parashikuar në pikën 1, ai që ka të drejtën ka paraqitur një reklamim pranë njëres prej hekurudhave të caktuara në nenin 49 pika 1;

b) brenda afatit të parashikuar në pikën 1, hekurudha përgjegjëse ose nëse, sipas nenit 26 pika 4, dy hekurudha janë përgjegjëse, njëra prej tyre ka pasur dijeni, nëpërmjet një rruge tjetër, për aksidentin që i ka ndodhur udhëtarit;

c) aksidenti nuk ka qenë njoftuar ose ka qenë njoftuar me vonesë, në vijim të rrethanave që nuk mund t'i hidhen atij që ka të drejtën;

d) ai që ka të drejtën provon që aksidenti ka pasur për shkak një gabim të hekurudhës.

Neni 54

Shuarja e padisë së lindur nga kontrata e transportit të bagazheve

1. Pranimi i bagazheve nga ai që ka të drejtën shuan çdo padi kundër hekurudhës të lindur nga kontrata e transportit, në rastin e humbjes pjesore, të dëmtimit ose të vonesës në dorëzim.

2. Megjithatë, padia nuk shuhet:

a) në rastin e humbjes pjesore ose të dëmtimit, nëse:

1. humbja ose dëmtimi janë konstatuar përpara pranimi të bagazheve nga ai që ka të drejtën konform nenit 48;

2. konstatimi që duhej të ishte bërë konform nenit 48 nuk është bërë për faj të hekurudhës;

b) në rast dëmi jo të dukshëm, egzistenca e të cilit konstatohet pas pranimi të bagazheve nga ai që ka të drejtën, nëse ky:

1. kërkon konstatimin konform nenit 48 menjëherë pas zbulimit të dëmit dhe jo me vonë se brenda tre ditëve që vijnë marrjen e bagazheve;

2. përveç kësaj provon që dëmi ka ndodhur midis pranimi për transport dhe dorëzimit;

c) në rast vonese në dorëzim, nëse ai që ka të drejtën, brenda njëzet e një ditëve ka ushtruar të drejtat e tij pranë njëres prej hekurudhave të caktuara nga neni 51, pikës 3;

d) nëse ai që ka të drejtën provon që dëmi ka pasur për arsye një mashtrim ose një gabim të rëndë që i ngarkohet hekurudhës

Neni 55

Parashkrimi i padisë

1. Paditë për dëmshpërblimet e bazuara në përgjegjësinë e hekurudhës në rastin e vdekjes dhe të plagosjes së udhëtarëve parashkruhen

a) për udhëtarin për tre vjet, duke filluar llogaritjen që nga dita e nesërme e aksidentit;

b) për persona të tjerë që kanë të drejtën, për tre vjet duke filluar llogaritjen nga dita e nesërme e vdekjes së udhëtarit, pa mundur të kalohet megjithatë ky afat deri në pesë vjet, duke filluar llogaritjen nga dita e nesërme e aksidentit.

2. Paditë e tjera që lindin nga kontrata e transportit parashkruhen për një vit.

Megjithatë parashkrimi është dy vjet nëse është fjala për një padi të bazuar në një dëm që rezulton nga një veprim ose një harresë e kryer qoftë me qëllim për të provokuar një dëm të tillë, qoftë nga një iniciativë e tepruar dhe me ndërgjegje që një dëm i tillë do të rezultonte nga ajo mundësisht.

3. Parashkrimi i parashikuar në pikën 2 fillon për padinë:

a) mbi dëmshpërblimin për humbjen tërësore: nga dita e katërmëdhjetë që ndjek mbarimin e afatit të parashikuar në nenin 23 pikën 3;

b) mbi dëmshpërblimin për humbjen pjesore, dëmtimin ose vonesën në dorëzim nga dita kur është bërë dorëzimi;

c) mbi pagesën ose mbi rimbursimin e çmimit të transportit, të shpenzimeve ndihmëse ose të mbitaksave, ose të korigjimit në rast të zbatimit të parregullt të një tarife ose të një gabimi në llogaritjen ose në marrjen e një takse: nga dita e pagesës ose, nëse nuk ka pasur pagesë, nga dita kur pagesa do të kryhej;

d) mbi pagesën e një shtese të detyrimit të kërkuar nga doganat ose autoritetet e tjera administrative: nga dita e kërkesës së këtyre autoriteteve.

Dita e kërkuar si pikë nisje e parashkrimit nuk përfshihet kurrë në afat.

4. Në rastin e reklamimit drejtuar hekurudhës konform nenit 49 me dokumentet justifikuese të nevojshme, parashkrimi pezullohet deri në ditën kur hekurudha hedh poshtë reklamimin me shkrim dhe kthen dokumentet. Në rastin e pranimin pjesor të reklamimit, parashkrimi fillon përsëri për pjesën e reklamimit që mbetet në mosmarrëveshje. Prova e pranimin të reklamimit ose e përgjigjes dhe ajo e kthimit të dokumenteve është në ngarkim të palës që kërkon këtë fakt. Reklamimet e mëtejshme që kanë të njëjtën objekt nuk pezullojnë parashkrimin.

5. Padia e parashkruar nuk mund të ushtrohet më, edhe në formën e një kërkesë që rrjedh nga një marrëveshje ose të një përjashtimi.

6. Nën rezervën e dispozitave të mëparshme, pezullimi dhe ndërprerja e parashkrimit rregullohen nga e drejta kombëtare.

KREU V MARRËDHËNIET E HEKURUDHAVE MIDIS TYRE

Neni 56 **Rregullimi i llogarive ndërmjet hekurudhave**

Çdo hekurudhë duhet t'u paguajë hekurudhave të tjera të interesuara pjesën që atyre u takon në një çmim transporti që ajo ka arkëtuar ose do të duhej të arkëtonte.

Neni 57 **Rekursi në rast humbje ose dëmtimi**

1. Hekurudha që ka paguar një dëmshpërblim për humbjen tërësore ose pjesore ose për një dëmtim të bagazheve, sipas rregullave uniforme, ka të drejtën e rekursit kundrejt hekurudhave që kanë marrë pjesë në transport konform dispozitave vijuese:

a) hekurudha që ka shkaktuar dëmin është e vetmja përgjegjëse për të;

b) kur dëmi është shkaktuar nga shumë hekurudha, secila prej tyre përgjigjet për dëmin që ajo ka shkaktuar; nëse dallimi është i pamundur, dëmshpërblimi ndahet midis tyre konform pikës c);

c) nëse nuk mund të provohet që dëmi është shkaktuar nga një ose shumë hekurudha, dëmshpërblimi ndahet midis të gjitha hekurudhave që kanë marrë pjesë në transport, me përjashtim të atyre që provojnë që dëmi nuk është shkaktuar në linjat e tyre. Shpërndarja bëhet proporcionalisht me distancat kilometrike të zbatimit të tarifave.

2. Në rast pamundësie pagese të një prej këtyre hekurudhave, pjesa që asaj i takon dhe që nuk është paguar prej saj ndahet midis të gjitha hekurudhave të tjera që kanë marrë pjesë në transport, proporcionalisht me distancat kilometrike të zbatimit të tarifave.

Neni 58

Rekursi në rast vonesë në dorëzim

Neni 57 zbatohet në rast dëmshpërblimi të paguar për vonesën në dorëzim. Nëse kjo është shkaktuar nga shumë hekurudha, dëmshpërblimi ndahet midis këtyre hekurudhave proporcionalisht me kohëzgjatjen e vonesës në linjat e tyre respektive.

Neni 59

Procedura e rekursit

1. E drejta e pagesës së kryer nga hekurudha që ushtron një nga rekursët e parashikuara në nenin 57 dhe 58 nuk mund të kundërshtohet nga hekurudha kundrejt së cilës ushtrohet rekursi, kur dëmshpërblimi ka qenë caktuar juridikisht dhe që kjo hekurudhë e fundit, e thirrur siç duhet në gjyq, ka qenë në gjendje të ndërhyjë në proces. Gjykatësi që trajton padinë kryesore fikson afatet e dhëna për njoftimin e thirrjes dhe për ndërhyrjen.

2. Hekurudha që ushtron rekursin e saj duhet të drejtojë kërkesën e saj në një dhe vetëm një instancë kundër të gjitha hekurudhave me të cilat nuk është marrë vesh, duke rrezikuar të humbë rekursin e saj kundër atyre që nuk u ka bërë thirrje.

3. Gjykatësi duhet të vendosë me një dhe vetëm një gjykim mbi të gjitha rekursët që ai ka marrë.

4. Hekurudhat e paditura nuk mund të ushtrojnë asnjë rekurs të mëtejshëm.

5. Nuk mund të futen rekurse në instancën që lidhet me padinë për dëmshpërblim të ushtruar nga ai që ka të drejtën ndaj kontratës së transportit.

Neni 60

Kompetenca për rekursët

1. Juridiksioni i selisë së hekurudhës kundrejt së cilës ushtrohet rekursi, është i vetmi kompetent për të gjitha paditë në rekurs.

2. Kur padia duhet të ngrihet kundrejt shumë hekurudhave, hekurudha paditëse ka të drejtën për të zgjedhur, midis juridiksioneve kompetente sipas pikës 1, atë para të cilit ajo do të paraqesë padinë.

Neni 61

Marrëveshjet lidhur me rekursët

Nëpërmjet marrëveshjeve, hekurudhat mund të mos i përmbahen dispozitave të rekurseve reciproke të këtij kreu, me përjashtim të atyre të nenit 59 pika 5.

KREU VI

DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 62

Shkeljet

Dispozitat e rregullave uniforme nuk mund të kenë fuqi më të madhe se ato që disa shtete janë të angazhuara në trafikun midis tyre në zbatim të disa traktateve, të tilla si traktatet lidhur me Komunitetin Europian të Qymyrit dhe të Çelikut dhe të Komunitetit Ekonomik Europian.

LIGJ
Nr.9304, datë 28.10.2004

PËR LEGALIZIMIN DHE URBANIZIMIN E ZONAVE INFORMALE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt:

- a) legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat informale, të përcaktuara sipas procedurave të këtij ligji;
- b) urbanizimin e zonave të zëna nga ndërtimet e banesave pa leje, të emërtuara “informale”, për integrimin e tyre në zhvillimin territorial e infrastrukturor të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në to.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për efekt legalizimi dhe urbanizimi në ndërtimet pa leje brenda territorit të zonës informale, të përfunduara në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji për rastet:

- a) që legalizohen në përputhje të plotë me studimin urbanistik të zonës informale të miratuar;
- b) që legalizohen pasi ridimensionohen për t’u përshtatur me studimin urbanistik të zonës informale të miratuar;
- c) që prishen, pasi vijnë në kundërshtim me studimin urbanistik të zonës informale të miratuar.

2. Janë objekt legalizimi:

- a) ndërtimet e banesave pa leje, duke përfshirë edhe sipërfaqet me funksion jobanimi brenda tyre;
- b) ndërtimet pa leje me funksion arsimor e shëndetësor;
- c) ndërtimet e veçanta pa leje, të ndërtuara me lejen e pronarit të truallit, kur janë në përputhje me studimin e miratuar të zonës përkatëse dhe plotësojnë kushtet e nenit 77 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

Neni 3
Përkufizime

1. “Zonë informale”, e miratuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH), është:

- a) zona e ndërtuar pa u bazuar në studime urbanistike;
- b) zona e zënë nga ndërtimet e banesave pa leje;
- c) zona që nuk gëzon mbrojtje të veçantë nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

2. “Ndërtim pa leje” është objekti i ndërtuar nga shtetasi brenda territorit të përcaktuar “Zonë informale”, për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

3. “Urbanizim” është përcaktimi i bërë në nenin 1 pika 16 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

4. “Legalizim” është pajisja me dokumentin e lejes së legalizimit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe kriteret e përcaktuara nga studimi urbanistik i zonës informale, pas zgjidhjes së pronësisë mbi parcelën ndërtimore.

5. “Leje legalizimi” është akti administrativ, i cili bashkë me dokumentacionin tekniko-ligjor paraqitet për regjistrimin e objektit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

6. “Parcela ndërtimore” është sipërfaqja nën objekt plus sipërfaqen funksionale të saj.

KREU II PËRGJEGJËSITË DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE PÛRKATËSE

Neni 4

Respektimi i procedurave

Ndërtimet pa leje në zonën informale legalizohen duke respektuar në çdo rast procedurat e përcaktuara në legjislacionin për urbanistikën.

Neni 5

Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale

1. Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale bashkërendon punën me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për:

- a) hartimin e studimeve urbanistike;
- b) njësimin e procedurave për procesin e urbanizimit dhe legalizimit të zonave informale;
- c) sigurimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit për urbanizimin e zonave informale

2. Ministri, që mbulon veprimtarinë shtetërore të planifikimit të territorit, nxjerr udhëzim për procedurat e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për ndërtimin e banesave pa leje në zonat informale.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të kësaj Agjencie përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Detyrat e njësisë së urbanistikës të njësisë së qeverisjes vendore

Sipas këtij ligji, njësitë e urbanistikës pranë njësive të qeverisjes vendore kanë këto detyra:

- a) verifikojnë gjendjen reale të ndërtimeve;
- b) bëjnë përditësimin teknik të planvendosjes në terren të ndërtimeve të banesave pa leje dhe të territoreve të zëna nga këto të fundit, në kufijtë dhe shtrirjen sipërfaqësore të zonës informale, të miratuar nga KRRTRSH-ja;
- c) hartojnë detyrat e projektimit për studimet urbanistike, sipas përcaktimit të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 7

Detyrimet e shtetasve për legalizimin e ndërtimeve pa leje

Për ndërtimet pa leje, shtetasit detyrohen:

- a) që për një periudhë 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të bëjnë pranë njësisë së urbanistikës të njësive të qeverisjes vendore përkatëse vetëdeklarimin e ndërtimit pa leje që kanë përfunduar dhe të sipërfaqes së zënë, sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij ligji;

b) që të paraqesin në njësinë e urbanistikës të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor, sipas formularit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda një periudhe njëvjeçare pas miratimit të studimit urbanistik të zonës informale.

KREU III PROCEDURAT

Neni 8

Etapat e realizimit të procesit të legalizimit

Procedurat për realizimin e procesit të legalizimit janë:

a) vetëdeklarimi nga ana e shtetasve i ndërtimeve pa leje dhe i territorit të zënë nga ndërtimi i banesës brenda zonës informale;

b) kërkesa e argumentuar e njësisë së qeverisjes vendore, pas evidentimit të sipërfaqes së zënë nga ndërtimi i banesave pa leje, për përfshirjen e tyre në procesin e urbanizimit dhe të legalizimit. Kjo kërkesë depozitohet në Sekretarinë Teknike të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH) brenda gjashtë muajve nga mbarimi i afatit të përcaktuar në shkronjën “a” të nenit 7 të këtij ligji;

c) kërkesa për përfshirjen në procesin e urbanizimit dhe legalizimit të sipërfaqes së zënë shqyrtohet në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë. Përcaktimi “Zonë informale”, mbi të cilën sjell pasoja juridike ky ligj, bëhet me vendim të KRRTRSH-së.

Mbi bazën e këtij përcaktimi KRRTRSH-ja vendos kryerjen ose rishikimin e studimeve urbanistike për këto zona.

Kjo kërkesë shqyrtohet brenda tre muajve nga data e depozitimit të saj në Sekretarinë Teknike të KRRTRSH-së;

ç) hartimi i studimeve urbanistike të këtyre zonave bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore brenda gjashtë muajve, pas miratimit të zonës informale;

d) miratimi i studimeve urbanistike nga KRRTRSH-ja bëhet brenda katër muajve nga miratimi i tyre nga KRRT-të përkatëse;

dh) lejimi për fillimin e legalizimeve të ndërtesave të banimit pa leje nga KRRTRSH-ja bëhet pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë ligj;

e) Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, vendos për kryerjen e studimeve urbanistike për zona të veçanta.

Neni 9

Dhënia e lejes së legalizimit

1. KRRTRSH-ja, në zbatim të studimit të miratuar me vendim të saj për zonën informale në shqyrtim, autorizon fillimin e legalizimeve për ndërtimet pa leje në të, vetëm pasi njësia e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me strukturën që mbulon fushën për prishjen e ndërtimeve pa leje, të ketë realizuar lirimin e sipërfaqeve të parashikuara për funksione publike në studimin urbanistik të zonës përkatëse.

2. Kur plotësohen kushtet, sipas këtij neni dhe neneve 7, 8 dhe 10 të këtij ligji, njësia e qeverisjes vendore, që mbulon sipërfaqen e zonës informale, për të cilën është miratuar studimi urbanistik, i lëshon lejen e legalizimit kërkuar, sipas formularit përkatës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Mënyra dhe afati i shlyerjes së detyrimeve financiare, të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe formulari i legalizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV PRONËSIA MBI SIPËRFAQEN E ZËNË

Neni 10

Zgjidhja e pronësisë mbi parcelën ndërtimore

Zgjidhja e pronësisë mbi parcelën ndërtimore nga ndërtimet e banesave pa leje bëhet si më poshtë:

1. Kur sipërfaqja e zënë nga ndërtimet në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji është pronë jopublike e paluajtshme e shtetit, kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore te pronari i banesës bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil, si më poshtë:

me pagesë të menjëhershme;

b) me pagesë me këste;

c) me marrjen me qira për një periudhë të caktuar.

Mënyrat e pagesës, të ndarjes së kësteve, të marrjes me qira, të afateve dhe kushteve lehtësuese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Vlerësimi i pronës bëhet sipas vlerës së tregut në çastin e kryerjes së legalizimit. Vlera e kësaj prone përcaktohet në përputhje me metodologjinë e propozuar nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me vendim të Kuvendit.

2. Kur sipërfaqja e zënë nga ndërtimet është pronë private, legalizimi i banesës bëhet pas kalimit të pronësisë mbi sipërfaqen e zënë nga pronari te ndërtuesi i banesës, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Në rastet kur ky kalim nuk realizohet, pronari i sipërfaqes së zënë nga ndërtimet kompensohet në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”. Në këtë rast, kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore te ndërtuesi i banesës bëhet sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni.

Neni 11

Përcaktimi i sipërfaqes së parcelës ndërtimore

1. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore, për efekt legalizimi të banesës, duhet të jetë në çdo rast sa trefishi i sipërfaqes që zë objekti, por jo më shumë se 500 metra katrorë.

2. Shtetasve, banesa e të cilëve prishet nga studimi urbanistik, u mundësohet vënia në dispozicion e parcelave të lira ndërtimore nga njësia e qeverisjes vendore, të krijuara nga studimi urbanistik.

3. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim kriteret dhe procedurat, mbi bazën e të cilave bëhet llogaritja e sipërfaqes funksionale të objektit që do të legalizohet, në përputhje me studimin urbanistik të miratuar.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 12

Dispozita detyruese

Mosdeklarimi brenda afatit kohor, deklarimi i rremë i ndërtimit dhe i sipërfaqes së zënë, si dhe mosparaqitja e dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor sjell përjashtimin nga trajtimi dhe mospajisjen me dokumentin e legalizimit të shtetasve që kanë ndërtuar pa leje në zonat informale.

Neni 13

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore, sipas përcaktimeve të neneve 5, 7, 8, 9, 10 e 11 dhe procedurën e mëtejshme të zbatimit të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të nxjerrë udhëzimin, sipas përcaktimit të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4403, datë 23.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia / Komuna _____

Vetëdeklarim për legalizim

A- Të dhëna vetjake të zotëruesit të objektit

Deklaruesi _____

Emër

Atësi

Mbiemër

Adresa e truallit të ndërtimit _____

Viti i ndërtimit ____ / ____ / ____

Funksioni i objektit _____

Ky dokument shoqërohet me certifikatën familjare të vetëdeklaruesit.

B- Lloji i pronësisë mbi të cilën është ndërtuar

1. Pronë private nëse po (Shëno me kryq) ☐

2. Pronë publike (Shëno me kryq) ☐

3. Pa njohje pronësie (Shëno me kryq) ☐

Nëse është pronë private e vetëdeklaruesit, të shoqërohet me certifikatë pronësie nga ZRPP përkatëse.

C- Të dhëna urbanistike për objektin

Sipërfaqja e zënë _____ (m²)

Sipërfaqja e ndërtimit _____ (m²)

Koeficienti i shfytëzimit të truallit _____ %

Pozicioni topografik (kufizimet) :

Veriu : _____

Jugu : _____

Lindja : _____

Perëndimi : _____

Distanca nga aksi i rrugës _____ m

Distanca nga trotuari _____ m

D- Të dhëna ndërtimore për objektin

Numri i kateve mbi tokë _____, nën tokë _____

Lartësia e përgjithshme e objektit _____ (m)

Volumi _____ (m³)

Lloji i mbulesës _____

Hyrja kryesore nga _____

Hyrjet e shërbimit nga _____

Kushte të veçanta _____

Ky dokument të shoqërohet me fotografi të katër pamjeve të objektit.

Projektues (nëse ka) _____

Zbatues (nëse ka) . _____

Emër Mbiemër Nr. Licencës

Emër Mbiemër Nr. Licencës

Për sa më sipër, deklaroj se janë të vërteta dhe të sakta.

Vetëdeklaruesi

Për Njësinë e Qeverisjes Vendore

Emër Mbiemër Firma

Datë ____ / ____ / 200__

Shënim: Ky dokument është hapi i parë për legalizim, por i pamjaftueshëm. Ai duhet të plotësohet nga kërkesat e tjera të ligjit.

LIGJ
Nr.9306, datë 4.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për ripranimin e personave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4405, datë 25.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë (të quajtura më poshtë “Palë Kontraktuese”),

me dëshirën për të pasur marrëdhënie miqësore midis të dy shteteve;

të udhëhequr nga qëllimi për të bashkëpunuar në bazë të trajtimit reciprok të çështjes së ripranimit të personave që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese;

me dëshirë për të kontribuar në parandalimin e lëvizjes së paligjshme të personave dhe në përputhje me parimet e bashkëpunimit europian, si dhe në përputhje me interesat dypalëshe, ranë dakord si vijon:

I
RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 1

1. Secila Palë Kontraktuese do të pranojë në territorin e shtetit të saj, me kërkesën e Palës tjetër Kontraktuese dhe pa asnjë formalitet, personin që qëndron në mënyrë të paligjshme me territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese nëse provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme se personi zotëron shtetësinë e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Pala Kontraktuese kërkuese do të ripranojë personin e të cilit iu referuam në paragrafin 1 sipas të njëjtave dispozita, nëse më vonë, në bazë të hetimeve të mëtejshme, përcaktohet se në kohën kur ai/ajo u transferua nga territori i shtetit të palës kërkuese ai/ajo nuk e zotëronte shtetësinë e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Në rast kur personi i përmendur në paragrafin 1 pranohet dhe ka nevojë për kujdes të veçantë për arsye të moshës së tij/saj, gjendjes së keqe shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, çdo Palë Kontraktuese informon për këtë palën tjetër. Përgjigjja e Palës së fundit Kontraktuese në lidhje me vendin dhe kohën e pranimit të atij personi dërgohen pa asnjë vonesë, jo më vonë se shtatë (7) ditë nga dhënia e njoftimit.

Neni 2

1. Nëse shtetësia provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i Palës Kontraktuese të kërkuar, me kërkesë të Palës Kontraktuese kërkuese, lëshon pa vonesë një dokument zëvendësues udhëtimi, që është i nevojshëm për kthimin e personit që pranohet në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.

2. Kur ka dyshime për vlefshmërinë e shtetësisë së prezumuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i Palës Kontraktuese të kërkuar do të intervistojë personin brenda tre (3) ditësh nga dorëzimi i kërkesës për pranimin e personit. Me miratimin e misionit diplomatik ose autoritetit konsullor, Pala Kontraktuese kërkuese do ta kryejë këtë shqyrtim brenda një kohe sa më të vogël. Nëse ky shqyrtim tregon se personi zotëron shtetësinë e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar, misioni diplomatik apo autoriteti konsullor do të lëshojë menjëherë një dokument zëvendësues udhëtimi.

II

RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 3

1. Nëse personi që ka hyrë në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese nuk arrin të përmbushë kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim, dhe nëse ky person ka një vizë të vlefshme ose një leje të vlefshme qëndrimi të lëshuar nga Pala Kontraktuese e kërkuar, Pala Kontraktuese e kërkuar ripranon atë me kërkesën e Palës Kontraktuese kërkuese dhe pa asnjë formalitet.

2. Nëse të dyja Palët Kontraktuese lëshuan një vizë ose një lejeqëndrimi, obligimi për të pranuar do të jetë i asaj Pale Kontraktuese, vlefshmëria e vizës ose lejes së qëndrimit e së cilës mbaron më vonë.

Neni 4

1. Pala Kontraktuese e kërkuar do të pranojë shtetas të vendeve të treta apo persona pa shtetësi me kërkesën e Palës Kontraktuese kërkuese, nëse kjo e fundit provon apo prezumon vlefshmërisht se personi i cili nuk i plotëson kërkesat efektive për hyrje apo qëndrim, e ka kaluar kufirin shtetëror të shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese pasi ka qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Detyrimi për të ripranuar sipas paragrafit 1 nuk do të aplikohet ndaj një personi, i cili në kohën e hyrjes në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese kishte një leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga ajo Palë Kontraktuese, ose të cilit i ishte dhënë leje qëndrimi nga ajo Palë Kontraktuese pas hyrjes së tij/saj.

3. Palët Kontraktuese sipas preferencave do të bëjnë përpjekje për të transferuar një shtetas të një vendi të tretë në shtetin e tij/saj të origjinës.

4. Pala Kontraktuese kërkuese ripranon një shtetas të një shteti të tretë ose një person pa shtetësi me të njëjtat kushte nëse më pas përcaktohet se në kohën e transferimit të tij/saj nga shteti i Palës Kontraktuese të kërkuar, nuk plotësoheshin kushtet e nenit 3 paragrafi 1 dhe nenit 4 paragrafi 1.

Neni 5

Detyrimi për të pranuar në përputhje me nenet 3 dhe 4 nuk do të aplikohet për një shtetas të vendeve të treta apo për një person pa shtetësi:

a) të cilit i është dhënë statusi i refugjatit nga Pala Kontraktuese kërkuese në bazë të konventës për Statusin e Refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe protokollit për Statusin e Refugjatëve (Nju Jork, 31 janar 1967),

b) i cili është transferuar më parë nga Pala Kontraktuese e kërkuar në shtetin e origjinës ose në ndonjë shtet tjetër,

c) shteti i të cilit ka kufi të përbashkët me shtetin e Palës Kontraktuese kërkuese,

d) që ka qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese për më shumë se gjashtë (6) muaj.

III TRANSITI

Neni 6

1. Secila Palë Kontraktuese lejon kalimin transit të një shtetasi të vendeve të treta përmes territorit të shtetit të saj kur kjo kërkohet me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese nëse Pala tjetër Kontraktuese kërkuese e garanton Palën Kontraktuese të kërkuar se personi, kalimi transit i të cilit lejohet, ka një biletë udhëtimi dhe një dokument të vlefshëm udhëtimi për në vendin që është destinacioni përfundimtar. Pala Kontraktuese kërkuese mban përgjegjësi të plotë për kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta përgjatë gjithë rrugës deri në shtetin e destinacionit përfundimtar. Pala Kontraktuese kërkuese mban përgjegjësi të plotë për kalimin transit të shtetasit të vendeve të treta përgjatë gjithë rrugës deri në shtetin e destinacionit përfundimtar dhe nëse është e nevojshme siguron eskortën e tij.

2. Në rast të kalimit transit në rrugë ajrore dhe me shoqërim të eskortës policore, Pala Kontraktuese kërkuese e siguron eskortën deri në shtetin e destinacionit përfundimtar ose deri në vendin tjetër transit ku eskorta policore nuk largohet nga zona ndërkombëtare e aeroportit të Palës Kontraktuese të kërkuar

Neni 7

1. Kalimi transit mund të refuzohet nëse një shtetas i palës së tretë është në rrezik për:

a) persekutim në shtetin e destinacionit për arsye race, feje, kombësie, antarësie në një grup shoqëror të caktuar ose për arsye të opinioneve të tij/saj politike;

b) ndjekje penale në shtetin e destinacionit ose ekzekutimi i një dënimi dhënë për një vepër penale të kryer para se të ndodhte transitimi, me përjashtim të rasteve të kalimit të paligjshëm të kufijve shtetërorë.

2. Një person që pranohet për transitim mund t'i kthehet Palës Kontraktuese kërkuese nëse faktet e përmendura në paragrafin 1 vërtetohen më pas.

IV RIMBURSIMI I SHPENZIMEVE

Neni 8

1. Shpenzimet lidhur me ripranimin e personave në zbatim të nenit 1 paragrafi 1, nenit 3 paragrafi 1 dhe neni 4 paragrafi 1 deri në momentin e marrjes në dorëzim të personit nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese të kërkuar, mbulohen nga Pala kontraktuese kërkuese. Shpenzimet në lidhje me kthimin e mundshëm të personave për t'u ripranuar do të mbulohen gjithashtu nga pala kërkuese.

2. Shpenzimet e transferimit të një shtetasi të një pale të tretë deri në kufirin e shtetit të destinacionit, duke përfshirë edhe shpenzimet që lidhen me transitimin përmes territorit të shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar, sikurse edhe shpenzimet që lidhen me një kthim të mundshëm të tij/saj mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuuese.

V MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 9

1. Të dhënat personale të komunikuara, të cilat janë të nevojshme për të realizuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje, mbrohen në përputhje me rregullat ligjore kombëtare të shteteve të Palëve Kontraktuese.

2. Nëse zbatimi i kësaj marrëveshjeje kërkon shkëmbim të dhënash personale ndërmjet Palëve Kontraktuese, për personat, këto të dhëna mund të jenë vetëm në lidhje me:

a) të dhënat personale të personit që duhet të transferohet ose të pranohet, të të afërmeve të tij saj (emri, mbiemri, emra të mëparshëm, pseudonime, aliase, data dhe vendi i lindjes, gjinia, shtetësia);

b) pasaportë, kartë identiteti, dokumente të tjera identiteti ose dokumente udhëtimi dhe lejekalimi (numri, data e skadimit, data e lëshimit, organi lëshues, vendi i lëshimit);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të indentifikuar personin që do të transferohet apo pranohet;

d) vendi i qëndrimit dhe rruga;

e) lejeqëndrimi apo viza të lëshuara nga Palët Kontraktuese.

VI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 10

1. Ministria e Rendit Publik e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë përfundojnë një protokoll zbatimi në të cilin ata specifikojnë:

a) dokumentet që provojnë apo prezumojnë në mënyrë të vlefshme shtetësinë e shteteve të Palëve Kontraktuese;

b) përmbajtjen e kërkesave për ripranim dhe transitim, mënyrën e paraqitjes së tyre dhe përpunimin i tyre;

c) mjetet për të provuar apo për të prezumuar në mënyrë të vlefshme hyrjen apo qëndrimin në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese;

d) autoritetet kompetente të autorizuar për të zbatuar këtë Marrëveshje;

e) pikat e kalimit kufitar të përdorura për zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 11

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të autorizuar për të zbatuar këtë Marrëveshje do të bashkëpunojnë dhe konsultohen drejtpërdrejt.

2. Në rast vështirësish në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për konsultim duhet të paraqitet përmes kanaleve diplomatike.

3. Secila Palë Kontraktuese cakton të paktën dy ekspertë për të vlerësuar zbatimin e Marrëveshjes dhe nëse do të jetë e nevojshme, paraqet propozime për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me zbatimin e saj. Në të tilla shqyrtime mund të ftohen edhe ekspertë të tjerë.

Neni 12

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk përmbajnë paragjykime ndaj detyrimeve në lidhje me pranimin apo transferimin e shtetasve të palëve të treta, të cilat dalin për Palët Kontraktuese nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e dispozitave të konventës për Statusin e Refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe protokollit për Statusin e Refugjatit (Nju Jork, 31 janar 1967).

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e marrëveshjeve të firmosura nga Palët Kontraktuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 13

1. Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e tridhjetë (30-të) pas datës së shkëmbimit të njoftimit nga Palët Kontraktuese, nëpërmjet të cilave ato njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes, plotësisht apo pjesërisht, me përjashtim të nenit 1, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik dhe shëndetit publik. Palët Kontraktuese njoftojnë pa vonesë njëra-tjetrën për marrjen e kësaj mase apo për anulimin e saj përmes kanaleve diplomatike. Pezullimi i zbatimit të Marrëveshjes hyn në fuqi në dorëzimin e njoftimit Palës tjetër Kontraktuese.

3. Secila Palë Kontraktuese mund të hedhë poshtë me shkrim Marrëveshjen përmes kanaleve diplomatike. Në rast të tillë, Marrëveshja skadon në ditën e nëntëdhjetë (90-të) pasi i dorëzohet njoftimi i përfundimit Palës tjetër Kontraktuese.

Bërë më 17.6.2004 në Shkup në dy kopje origjinale, secila prej të cilave në gjuhët shqipe, maqedonase dhe angleze të gjitha të barasvlershme. Në rast keqinterpretimi, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.9307, datë 4.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE, SUBSTANCave PSIKOTROPE E PREKURSORËVE, MIGRACIONIT TË PALIGJSHËM DHE VEPRIMTARIVE TË TJERA TË PALIGJSHME”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4406, datë 25.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE E PREKURSORËVE, MIGRACIONIT TË PALIGJSHËM DHE VEPRIMTARIVE TË TJERA TË PALIGJSHME

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë më poshtë të quajtura Palë Kontraktuese:

në frymën e miqësisë dhe të bashkëpunimit ekzistues ndërmjet të dy vendeve, të ndërgjegjshme për nevojën për të mbrojtur jetën, pronën, të drejtat themelore dhe liri të tjera të shtetasve të tyre,

duke pranuar avantazhet e bashkëpunimit ndërkombëtar si një faktor i një rëndësie shumë të madhe për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, emigracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme,

duke marrë në konsideratë dispozitat e konventave dhe traktateve ndërkombëtare në këtë fushë, në të cilat shtetet e Palëve Kontraktuese janë palë,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

1. Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre, bashkëpunojnë dhe asistojnë në mënyrë reciproke njëra-tjetrën në parandalimin dhe identifikimin e krimeve në fushat e mëposhtme:

- a) terrorizmi;
- b) krimi i organizuar;
- c) prodhimi i paligjshëm dhe hedhja në shitje e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;
- d) trafiku i personave e i organeve njerëzore dhe shfrytëzimi i fëmijëve;
- e) grabitja;
- f) prodhimi, tregtimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municionit dhe eksplozivëve, materialeve kimike, biologjike, bërthamore dhe radioaktive, mallra dhe teknologji me përdorim të dyfishtë, teknologji ushtarake, materiale, pajisje dhe përbërës që mund të përdoren për prodhim armësh të shkatërrimit në masë dhe materiale të tjera të rrezikshme;
- g) favorizimi i prostitucionit;
- h) vjedhja dhe tregtia e paligjshme e pasurive kulturore e historike, pasurive artistike, objekteve me vlerë kulturore e historike, metaleve e minerale të çmuara dhe objekteve të tjera me vlera të mëdha;
- i) falsifikimi i parave, letrave me vlerë, mjeteve të tjera të pagesës që nuk janë as para as letra me vlerë sikurse dhe nxjerrja e tyre në qarkullim apo përdorim;
- j) organizimi i lojërave të paligjshme të fatit dhe skemat e mashtrimit në lojërat e ligjshme të fatit;
- k) kontrabanda e mallrave të akcizës dhe krime të tjera të lidhura me tregtinë ndërkombëtare dhe shkëmbimin ekonomik, evazionin fiskal, pastrimin e parave dhe fitime të tjera të paligjshme;

1) vjedhja dhe tregtia e paligjshme e automjeteve, falsifikimi dhe përdorimi i dokumenteve të falsifikuara për ato automjete;

m) migracioni i paligjshëm-kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror, falsifikimi i pasaportave dhe vizave false dhe përdorimi i tyre;

n) krimet kundër jetës dhe shëndetit njerëzor;

o) krimet kundër mjedisit.

2. Duke rënë dakord në mënyrë reciproke Palët Kontraktuese zhvillojnë asistencë të ndërsjellë edhe në luftën ndaj krimeve të tjera. Palët Kontraktuese zhvillojnë asistencë të ndërsjellë vetëm për ato veprimtari që konsiderohen krime sipas legjislacioneve kombëtare.

3. Palët Kontraktuese bashkëpunojnë dhe zhvillojnë asistencë të ndërsjellë në fushat e mëposhtme:

a) metodat dhe mënyrat e përdorura për të siguruar, ruajtur e rivendosur rendin publik, për të ruajtur e mbrojtur objektiva të interesit publik e kombëtar, vlera dhe mallra, sikurse dhe për të garantuar sigurinë e personave të cilët marrin pjesë në demonstrimet publike;

b) parandalimi i dhunës;

c) organizimi, kryerja dhe menaxhimi i ruajtjes dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror në sektorët tokësore, detare apo liqenore për ruajtjen dhe mbikëqyrjen e kufirit.

4. Palët Kontraktuese bashkëpunojnë për trajnime profesionale bazë e të posaçme dhe në promovimin e ekspertëve të të dyja Palëve Kontraktuese në fushat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

1. Të dyja Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre bashkëpunojnë nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit dhe në fushat e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje;

b) marrjes së masave ose veprimeve për të cilat është rënë dakord në mënyrë të ndërsjellë nga ministritë dhe/ose organe të tjera kompetente të të dy shteteve;

c) shkëmbimit të ekspertëve të specializuar në fusha të interesit reciprok;

d) shkëmbimit të dokumentacionit, publikimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore të kryera në fusha të interesit reciprok;

e) shkëmbimit të informacioneve operacionale për të ndihmuar në parandalimin, identifikimin dhe hetimin e veprimtarisë së krimit të organizuar dhe krimeve të tjera.

2. Palët Kontraktuese bien dakord, pas përmbushjes së procedurave ligjore në fuqi në shtetet e tyre, në marrëveshje të ndërsjellë, për të dërguar oficerë ndërlidhës të caktuar nga autoritetet kompetente të përmendura në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

1. Për të përmbushur dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese caktojnë si autoritete kompetente:

Për palën shqiptare:

a) Ministria e Rendit Publik;

Për palën maqedonase:

a) Ministria e Punëve të Brendshme

2. Në mënyrë që të sigurohen lidhje operacionale, autoritetet kompetente caktojnë një person kontakti dhe Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për të dhënat e këtij personi, d.m.th. emri, mbiemri, pozicioni, numri i telefonit, faksit brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

3. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje kryhet në gjuhën angleze ose në ndonjë gjuhë tjetër për të cilën bihet dakord në mënyrë të ndërsjellë nga Palët Kontraktuese.

4. Në mënyrë që të realizohet bashkëpunimi, në përputhje me parashikimet e nenit 1, dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, me kompetencat e tyre të përcaktuara ligjërisht, mund të përfundojnë protokolle bashkëpunimi, duke respektuar legjislacionin kombëtar të të dy shteteve.

Neni 4

Palët Kontraktuese zhvillojnë asistencë të ndërsjellë në përpunimin dhe analizimin e informacioneve që i përkasin fushave të përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe mund t'u japin pajisje dhe teknologji specifike autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të ndërmarra në këtë fushë.

Neni 5

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Palët Kontraktuese:

a) Organizojnë takime ekspertësh brenda ministrive të tyre të brendshme dhe/ose institucioneve të tjera për fushat e tyre përkatëse të kompetencës, kur është e nevojshme të zgjidhen probleme urgjente e të veçanta si trafikimi i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, armëve të zjarrit dhe municionit, trafikimi i personave, rrjete të emigracionit të paligjshëm dhe forma të tjera të krimit të organizuar.

b) Zhvillojnë asistencë të ndërsjellë, bazuar në konsultime paraprake, brenda forumeve, organizmave e organeve të ndryshme ndërkombëtare përkatëse.

Neni 6

1. Secila Palë Kontraktuese mund ta refuzojë një kërkesë për bashkëpunim ose informacion nëse ajo konsideron se një kërkesë e tillë mund të rrezikojë sovranitetin ose sigurinë e Palës Kontraktuese të kërkuar, ose nëse një përmbushje e një kërkesë të tillë mund të bjerë në kundërshtim me legjislacionin kombëtar ose me angazhimet që dalin nga marrëveshje ndërkombëtare. Në raste të tilla, refuzimi i kërkesës i njoftohet pa vonësë Palës tjetër Kontraktuese.

2. Informacioni i siguruar në bazë të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet konfidencial dhe mund të përdoret nga autoritetet kompetente të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe vetëm për qëllim shkëmbimi dhe nuk i komunikohen apo jepen një shteti të tretë, përveçse në ato raste kur Pala Kontraktuese dërguese ka dhënë një miratim paraprak me shkrim.

3. Secila Palë Kontraktuese garanton mbrojtjen e të dhënave sekrete të marra në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, si kërkesa për informacion në përputhje të plotë me legjislacionin e saj kombëtar.

4. Secila Palë Kontraktuese ka si detyrë të fshijë apo eliminojë të dhëna në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Pala Kontraktuese dërguese, ose nëse kushte të tilla nuk janë caktuar, sapo këto të dhëna të mos jenë më të nevojshme për qëllimin për të cilin u kërkuar apo dërguan. Në rast përfundimi të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të dhënat e marra në bazë të saj duhet të fshihen apo eliminohen jo me vonë se data e përfundimit.

Neni 7

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikojnë të drejtat e angazhimet që dalin për Palët Kontraktuese nga konventa ose marrëveshje të tjera ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe.

2. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet nepërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 8

Shpenzimet e lidhura me zbatimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje sikurse edhe ato që lidhen me shkëmbimin e delegacioneve mbulohen në një bazë të ndërsjellë e rregullohen me përfundimin e protokolleve sipas nenit 3 paragrafi 4 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe mund të denoncohet apo pezullohet në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike. Denoncimi hyn në fuqi brenda 6 muajsh ndërsa pezullimi brenda 30 ditësh nga data e njoftimit.

Neni 10

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi datën e njoftimit të fundit të shkëmbyer përmes kanaleve diplomatike në lidhje me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Bërë në shkurt, më 17.6.2004 në dy origjinale secili në gjuhët shqipe, maqedonase e angleze ku të gjitha tekstet janë të barasvlefshëm. Në rast mospërputhjes në interpretim, për bazë merret teksti në gjuhën angleze.

DEKRET

Nr.4409, datë 26.11.2004

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të neit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Majlinda Tahir Ge (Kadriu) | 15. Manjola Haki Reiche (Reçi) |
| 2. Dorian Lutfi Schauer (Saqe) | 16. Elvana Fitim Luzi (Aliaj) |
| 3. Arben Haki Ademi | 17. Arnaldo Jozef Maleçek |
| 4. Haki Arben Ademi | 18. Enida Enver Okaj |
| 5. Eni Arben Ademi | 19. Bashkim Asllan Llanaj |
| 6. Eugert Luan Lazaj | 20. Kevin Bashkim Llanaj |
| 7. Jasemin Feta Laçe | 21. Irista Bashkim Llanaj |
| 8. Markeljan Behar Koçibelli | 22. Aida Neim Llanaj (Shyti) |
| 9. Gazmend Shkëlqim Kalem | 23. Agim Shaban Bejtaga |
| 10. Brunilda Pashk Feist (Sokoli) | 24. Matetheo Pali Konda |
| 11. Mirush Hysen Laçi | 25. Ina Matetheo Konda |
| 12. Dritan Luan Goga | 26. Tatjana Shafqet Konda (Islamaj) |
| 13. Rudina Din Kozoderc (Ismailaj) | 27. Anisa Metetheo Konda |
| 14. Ardian Bajram Uka | 28. Natasha Xhelal Ihmels (Barmashi) |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

URDHËR
Nr.2, datë 3.12.2004

PËR SEKUESTRIMIN E ASETVEVE TË SHTETASIT ARAB YASIN AL- QADI I NJOHUR DHE SI: A) SHAYKH YASSIN ABDULLAH KADI, B) YASIN KAHDI, C)YASSIN KADI, Ç) KADI JASSIN, D)YASSIN ABDULLAH KADI

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Luftën Kundër Financimit të Terrorizmit e vitit 1999, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”,

URDHËROJ:

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha llogaritë, investimet dhe asetet e Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Jassin, d) Yassin Abdullah Kadi, shtetas arab, Jeddah, Arabia Saudite.

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për personin e lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha llogaritë, çdo llogari që mbahet në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Jassin Kadi, d)Yassin Abdullah Kadi.

4. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë e identifikuar, specifikuar dhe renditur më poshtë (sipas numrave të llogarisë, bankave, emërimit të llogarisë) në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi b)Yasin Kahdi c)Yassin Kadi ç) Jassin Kadi d)Yassin Abdullah Kadi.

4.1	000101-3	Banka Arabe Shqiptaro-Islamike, sot Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA)	Yassin Kadi
4.2	000101-1	UBA	“Karavan Durrës STR Project” sh.p.k.
4.3	100347-2	UBA	“Karavan Durrës STR Project” sh.p.k.
4.4	100347-7	UBA	“Karavan Durrës STR Project” sh.p.k.
4.5	100347-6	UBA	“Karavan Durrës STR Project” sh.p.k.
4.6	100231-9	UBA	“Karavan”.
4.7	100231-8	UBA	“Karavan”.
4.8	100104	UBA	“MediCare CO” sh.p.k.
4.9	100104-6	UBA	“MediCare CO “ sh.p.k.
4.10	100459-2	UBA	“Medicare ltd (expenses)” sh.p.k.
4.11	100459-9	UBA	“Medicare ltd (expenses)” sh.p.k.
4.12	100549-3	UBA	“Albanian Snacks” sh.p.k.
4.13	100549-8	UBA	“Albanian Snacks” sh.p.k.
4.14	100101-1	UBA	“Cavallo-Revenue” sh.p.k.
4.15	100102-3	UBA	“Cavallo-Revenue” sh.p.k.
4.16	100101-7	UBA	“Cavallo-Revenue” sh.p.k.
4.17	100164-7	UBA	“Loxhall” sh.p.k.

4.18	100296-3	UBA	“Alintid Albania Office” sh.p.k.
4.19	100296-5	UBA	“Alintid Albania Office” sh.p.k.
4.20	100296-3	UBA	“Alintid Albania Office” sh.p.k.
4.21	201-01-40-01-100512-4	UBA	“Albanian International Investment & Developement Co” sh.p.k.
4.22	000134	UBA	“Albanian International Investment & Developement Co” sh.p.k.
4.23	000100	UBA	“Albanian International Investment & Developement Co” sh.p.k.
4.24	000690	UBA	“Albanian International Investment & Developement Co” sh.p.k.
4.25	3/001/000175/4	Banka Ndërkombëtare tregtare (BNT Malaizjane)	“Karavan”.
4.26	3/001/000160/2	BNT Malajziane	“Karavan”.
4.27	3/001/000070/7	BNT Malajziane	“Karavan”.
4.28	3/001/000238/3	BNT Malajziane	“Karavan”.
4.29	000710/3	BNT Malajziane	“Karavan” .
4.30	000700/	BNT Malajziane	“Loxhall”.
4.31	000428/ 2	BNT Malajziane	“Loxhall”.
4.32	3-001-000257-7	BNT Malajziane	“Albanian Investment Development”.
4.33	3-001-000257-8	BNT Malajziane	“Albanian Investment Development”.
4.34	200515	Banka Amerikane e Shqipërisë	“Loxhall”.
4.35	200203	Banka Amerikane e Shqipërisë	“Loxhall .
4.36	41337	Banka Amerikane e Shqipërisë (Saleh, Jasin Kadi, H.A. Rajan).	

5. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, mbajtur në emër, prej, për llogari ose në përfitim të Yasin Al-Qadi, i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi b) Yasin Kahdi c) Yassin Kadi ç) Jassin Kadi d) Yassin Abdullah Kadi shtetas arab, Jeddah, Arabia Saudite.

6. Të sekuestrohet menjëherë çdo pasuri e luajtshme ose jo, zotërimi i tyre ose llogaritë e mbajtura nga çdo njëri prej personave fizikë a juridikë të identifikuar më poshtë;

6.1 “KARAVAN” sh.p.k., regjistruar me vendim gjykatë nr.13051, datë 12.12.1995, e njohur gjithashtu dhe si “KARAVAN Constr Develop” sh.p.k., “KARAVAN Ltd,” “Karavan Construction & Development” sh.p.k., ose “KARAVAN” Co, ose “KARAVAN”; Tiranë dhe Durrës.

6.2 “Alintid Beton” sh.p.k., e njohur dhe si “Alintid”; Tiranë.

6.3 “Emane” sh.p.k., “Emane Ltd”, regjistruar me vendim gjykatë nr.1528, datë 14.8.1996, Tiranë.

6.4 “Camel” ose “KAMEL” sh.p.k., regjistruar me vendim gjykatë nr.15713, datë 27.8.1996, Tiranë.

6.5 “Albanian Snack” sh.p.k., “Snack, Ltd”, regjistruar me vendim gjykate nr.24391, datë 20.9.2000, Tiranë.

6.6 “Medicare” sh.p.k., “Medicare Imp & Exp”, regjistruar me vendim gjykate nr. 4716, datë 3.6.1994; Tiranë. 6.7.”Loxhall” sh.p.k., regjistruar me vendim gjykate nr.2922/1, datë 1.3.1999, (6240) datë 1.3.1999, ndryshuar emri i shoqërisë nga “Loks Holl” në “Cavallo” sh.p.k, regjistruar me vendim gjykate nr.2544, datë 22.3.1994,Tiranë.

6.7 “Albanian International Investment & Development Co” sh.p.k., krijuar me vendim të Gjykatës së Tiranës, nr.21618, datë 8.7.1999, degë e shoqërisë “Albanian International Investment & Development Co” Ltd, me seli në Tiranë dhe Agjent të Regjistruar Morgan & Morgan Trust Corporation Ltd.me seli në Road Town, Parsea Estate, P.O. Box 3149, Tortola, British Virgins Islands, Tiranë.

7. Të sekuestrohen pasuritë e paluajtshme, troje të mbajtura në emër, prej, për llogari ose në përfitim të Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Jassin Kadi d) Yassin Abdullah Kadi, shtetas arab, Jeddah, Arabia Saudite, të identifikuar me poshtë:

7.1 Truall 550 m² në zonën kadastrale (80 70), që kufizohet në lindje nga Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” në jug, pronë e qytetarit Besnik Shtino, në përfitim me familjen “Kotoni”, nga veriu rruga. Trualli është në vendin e ndërtimit të dy kullave 15+2 katëshe në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” Tiranë.

8. Të sekuestrohen, të bllokohen ambientet e identifikuar në dy kullat 15+2-katëshe një sipërfaqe prej 2 030 m², që mbahet në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të Yasin Al- Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi; b) Yasin Kahdi; c) Yassin Kadi; ç) Jassin Kadi; d) Yassin Abdullah Kadi shtetas arab, Jeddah, Arabia Saudite; ose e) shoqërinë “Karavan Construction & Development” sh.p.k., të identifikuar sipas koordinatave në pikat e mëposhtme:

8.1 Kati i pestë, një apartament; A4 me sipërfaqe 112 m².

8.2 Kati i gjashtë, katër apartamente, me sipërfaqe gjithsej 444 m².

8.3 Kati i shtatë, tre apartamente; A1 + A2 + A4, me sipërfaqe gjithsej 340 m².

8.4 Kati i nëntë, dy apartamente; A2 + A3, me sipërfaqe gjithsej 228 m².

8.5 Kati i dymbëdhjetë, katër apartamentet e katit; A1+A2+A3+A4, me sipërfaqe gjithsej 456 m².

8.6 Kati i trembëdhjetë, katër apartamente; A1+A2+A3+A4, sipërfaqe prej me 450 m².

9. Të sekuestrohen dhe të bllokohen pasuritë e paluajtshme ose të ardhurave nga shitja e pasurive, të identifikuar nga hetimet paraprake të bëra nga prokuroria, si pronë e shtetasit arab Abdyl Latif Saleh:

9.1 Kati nëntokë: (kuota 3.00-0.00) bashkëpronar me 2.5%.

9.2 Kati përdhe objektit, (kuota+0.00-+4.00) një ambient me sipërfaqe 22 m², me fasadë lindore, i kufizuar nga veriu me ambientin e Besnik Shtinos dhe nga jugu me ambientin e shoqërisë Karavan.

9.3 Kati i katërt: (Kuota+15.20-+18.40) të katër apartamentet që ndodhen në kate: A1-94 m², A2 - 94.5 m², A3 - 94 m² dhe A4-94.5 m². Gjithsej 377 m².

10. Për shkak se mund të jenë kryer lëvizje të llogarive, të investimeve dhe të pasurive të ngrira ose të sekuestruara të subjektit dhe për arsye se mund të mos jenë identifikuar që të gjitha llogaritë, investimet, shoqëritë tregtare apo persona juridikë të tjerë, dhe pasuritë e tjera në urdhrin nr.6737, prot.datë 14.11.2001, kërkohet nga të gjitha institucionet në Shqipëri, degët ose filialet e tyre vendase ose të huaja që të kontrollojnë regjistrat e tyre dhe të identifikojnë, sekuestrojnë, bllokojnë dhe raportojnë llogaritë, investimet, kompanitë dhe pasuritë në emër (at) e subjektit, duke filluar nga data 17.10.2001.

11. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë dhe pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 17.10.2001.

12. Të njoftohet menjëherë me shkrim drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, për llogaritë, investimet dhe pasuritë e tjera, si dhe për vendodhjen e tyre.

13. Të plotësohet Raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjekti duke filluar nga data 17.10.2001, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet tek drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

14. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjektit ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin. Nëse vëreni, konstatoni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

15. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale të lidhura përpara datës 17 tetor 2001, me shtetasin arab Yasin Al- Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi c) Yassin Kadi, ç) Kadi Jassin, d) Yassin Abdullah Kadi, me kompanitë ose investimet e tjera të tij subjekt i këtij urdhri, depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

16. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrira, të bllokuara, të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërim heqjet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi për këtë qëllim, duke filluar nga data 17.10.2001.

17. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 për masat kundër financimit të terrorizmit, si: Ministria e Financave, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave ("Autoriteti Përgjegjës" për parandalimin e pastrimit të parave, në Ministrinë e Financave), Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2004 për parandalimin e pastrimit të parave, të ndryshuar.

18. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
15.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 9.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë